



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPublika e KOSOVES
REPublika KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTT
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 01 Nr. 15634
U. Br.
Nr. i faq. 1 Data: 23/06
br. str. Datum:
KAMENICË/A 2025

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal i Kamenicës

Datë: 23.06.2025

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 23.06.2025 :

T H Ë R R E T

Mbledhjen e VI-të të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Hënë** me datë: **30.06.2025**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit, nga mbledhja e V-të e Kuvendit Komunal për vitin 2025.
2. Pyetje legjislativiteti drejtuar ekzekutivit.
3. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore, periudha 2026-2028.
4. Propozim vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal për vitin 2025-2033.
5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetorte të Komunës së Kamenicës për vitin 2024.
6. Kërkesë nga MAPL për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr. Sh.01 Nr. 10794.
7. Të ndryshme.



Kryesuesi i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOV QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTT CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
Sh. U.	Nr. Br.
01	15632
Nr. i faq.	Data:
12	23/06
Br. str.	Datum:
	KAMENICË/A 2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e V-të e Kuvendit të Komunës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës më: 30.05.2025 dhe filloj ora 10:10. Në mbledhje përveç delegatëve të kuvendit, të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës së Kamenicës, disa drejtor të drejtorive komunale, shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, përfaqësues nga zyra për integritet evropian, zyra e informimit dhe OSBE. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Liridon Kastrati i cili për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e IV-të e Kuvendit Komunal për vitin 2025,
2. Pyetje të legjislativit drejtuar ekzekutivit,
3. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Planit të Punës për Ekipin Komunal për të drejtat e Fëmijës, Kamenicë për vitin 2025-2027,
4. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, për zonën kadastrale në Bratilloç, me nr.P-71107008-000-25-0.
5. Propozim vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, për parcelën me nr.P-71107008-000-25-0.
6. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, për zonën kadastrale në Kamenicë, me nr.P-71107041-01981-0.
7. Propozim vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, për parcelën me nr.P-71107041-01981-0.
8. Propozim vendim për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “ Ndërtimi i varrezave në fshatin Hodonoc” në mes Komunës së Kamenicës dhe participimit të Këshillit Lokal të Fshatit Hodonoc,
9. Propozim-vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm publik nën menaxhimin të AKP-së me nr. të parcelës P-71107041-01157-2,
10. Propozim vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Solar Green Energy SH.P.K” me procedurë të negocimit të ofertës.

11. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik për parcelat me nr. P-71107041-01336-1, P-71107041-01338-0, P-71107041-01339-0, P-71107041-01335-0,
12. Propozim vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për parcelat me nr.P-71107041-01336-1, P-71107041-01338-0, P-71107041-01339-0, P-71107041-01335-0,
13. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik për parcelat me nr.P-71107079-00558-2 dhe P-71107079-00308-0,
14. Propozim-vendim për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për parcelën me nr.P-71107079-00558-2 dhe P-71107079-00308-0,
15. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik për parcelat me nr. P-71107074-00868-0, 03101-0. 00022-0, 00816-0, 00816-0,
16. Propozim vendim për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për parcelën nr. P-71107074-00868-0, 03101-0, 00022-0, 00816-0, 00816-0,
17. Propozim- vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “ Veton Kallaba B.I” me procedurë të negocimit të ofertës,
18. Propozim-vendim për formimin e komisionit të ankesave,
19. Kërkesë për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr.8623 për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike,
20. Kërkesë për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr.8628, i VSM e Planeve Nderkomunale per menaxhimin e Integruar të mbeturinave për Komunitet e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Hani i Elezit, Shtërpçë-Kosovë.
21. Kërkesë për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr. 8627 i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajit,
22. Të ndryshme.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-fillimisht konstatojmë se kemi kuorum për ta filluar këtë mbledhje. Fillimisht kemi një propozim-vendim.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës, kemi një propozim-vendim për ndërtimin e trafos që është një bashkëpunim me SHIKOS- Ujin “ Kika” në diskutim me kompaninë KEDS-in kemi arritur një dakordancë që të ndërtohet një trase e re elektrike, ngase ka vite që kompania në fjalë ballafaqohet me mungesë të energjisë. Nëse do të ishte e mundur që të jetë pjesë e rendit të ditës, në mënyrë që të i ndihmojmë këtij prodhuesi vendor.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- vazhdojmë me miratimin e tërësishëm të rendit të ditës?

Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e IV-të e Kuvendit Komunal për vitin 2025,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- jemi në pikën e parë të rendit të ditës, a keni vërejte rreth procesverbalit, nëse nuk keni vazhdojmë me procedurën e votimit?

Kush është për miratimin e procesverbalit?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

2. Pyetje të legjislativit drejtuar ekzekutivit,

Egzona Zuzaku-Isufi, Intervistimi i drejtorëve të shkollave nga Prokuroria

Kërkova sqarim për arsyet e intervistimit të dy drejtorëve të shkollave nga ana e Prokurorisë dhe nëse ka ndonjë procedurë disiplinore në zhvillim. Qentë endacakë në hapësirat publike ngrita shqetësim për prezencën e qenve endacakë në shesh dhe në park, duke kërkuar masa emergjente për menaxhimin e situatës për të garantuar sigurinë publike.

Mungesa e ujës jellësit në lagjen Grizime. Kërkova sqarim dhe planifikim konkret për zgjidhjen e problemit të mungesës së ujit të pijshëm në këtë lagje. Rikthimi në punë i një zyrtari të komunës pas vendimit gjyqësor. E adresova pyetjen nëse rikthimi i zyrtarit në punë pas fitimit të lëndës në gjykatë përbën padrejtësi ndaj kolegëve të tjerë apo nëse ka pasoja në mbarëvajtjen e punës institucionale. Ndalimi i punimeve në fshatin Setllar - Kranidell Kërkohet informacion mbi arsyet e ndalimit të punimeve dhe nëse ka ndonjë afat për rifillimin e tyre. Gjendja alarmante në rrugën "Avdyl Frashëri" pranë lumit.

Theksova se gjendja pranë këtij segmenti rrugor është alarmante, veçanërisht gjatë vërshimeve, dhe kërkohet ndërhyrje urgjente për të parandaluar rreziqet për jetën dhe pronën e qytetarëve. Mungesa e pajisjeve higjienike në shkollën "17 Shkurti" në Muçivërc Me shqetësim serioz që stafi i shkollës detyrohet të blejë me mjete personale produkte higjienike për ambientet e shkollës. Kërkohet ndërhyrje urgjente dhe sigurim i furnizimit bazë. Ndarja e taksave për OJQ-të jashtë komunës. Dhe drejtova pyetjen pse fondet komunale janë ndarë për organizata joqeveritare në qytetin e Gjilanit dhe nëse kjo është në përputhje me parimin e përkrahjes së nevojave lokale të qytetarëve të Kamenicës. Sa ka kushtuar tabela informuese në hyrje të qytetit.

Jadranka Nikolić-pse nuk ka hyrë në rend dite pyetja e kërkuar që është adresuar për drejtorin e arsimit dhe nuk është dërguar në email?

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-zyrtarisht po e njoftoj edhe kryetarin që si anëtarë të Komiteti për Politikë dhe Financa kemi bërë një shkresë të përbashkët dhe ju kemi adresuar Drejtorit të Arsimit për një listë, po ka tre muaj që nuk kemi përgjigj.

Jadranka Nikolić-ju e dini komplet situatën për vazhdimin e kontratave se deri kur vlejnë për punëtorët arsimor me shpalljen për emërimin e drejtorëve, paguhen drejtorët që gjinden jashtë vendit.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- këto diskutime që janë bërë besoj se në seancën tjetër do të na sjellët me material të gjitha pyetjet që janë parashtruar.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës-sa i përket për rastin e drejtorit Afrim Dervishi dhe Selami Klaiqit, nuk kam njohuri, ndërsa për të gjitha OJQ-të është thirrja publike për të gjithë dhe nuk duhesh me kufizuar një lokacion të caktuar. Në momentin që e kufizon vetëm komunën tonë shkruan Ministria e Financa. Për tabelën informuese nuk kam informacion, besoj drejtorja ka informacion më të detajuar është në kuadër të projektit për sinjalistikë rrugore. Për rastin e zyrtarit që e ka fituar në gjykatë ne nuk kemi marrë asnjë veprim administrativ ndaj tij, ka qenë kontrata me afat të caktuar ne as nuk e kemi vazhduar por as nuk e kemi nënshkruar, nuk ka nënshkrim nga asnjë drejtues por as nga unë. Ujësijellësi në lagjen Grizime është plotësisht shqetësues me vend është sipërfaqe shumë e madhe që shumë banorë kanë mungesë të ujit të pijshëm dhe Hidromorava nuk ka shtrirje të ujësijellësit të asaj zone. Vitin e kaluar e kemi shpuar një pus dhe është dalë ujë i pijshëm, ndërsa këtë vit prap është nxjerr një pus i ri, ujë ka por duhet të presim nëse uji del i pijshëm ose jo. Sa i përket mjeteve higjienike nëpër shkollë unë e di se ka edhe kontrata aktuale dhe kontrata në proces e sipër për furnizim të rregullt normal që pastërtia duhet të jetë në nivel për shkak edhe të shëndetit të fëmijëve. Sa i përket eliminimit të qenve endacak nuk mund ta bëjmë, por trajtimin mund të bëjmë, krastimin sikur çdo komunë që e bënë. Ne kemi ndarë edhe edhe parcelën për ndërtimin e strehimores për qentë endacak e kemi bërë edhe projektin, ky projekt kap vlerën prej 1.5 milion euro për komunë tonë është shumë e madhe me investuar në momentin që gjejmë fonde do të bëhet një zgjidhje më e qëndrueshme. Rruga “Avdyl Frashëri” ku gjendja është shumë e keqe këtë rrugë e kemi nënshkruar me ministrin Hysen Durmishi dhe jemi në proces të asfaltimit të kësaj rruge, ndërsa rruga Kranidell-Sedllar është ndërprerë vetëm një segment shumë i shkurtër e cila nuk ka qenë në kontratë të parë dhe kompania thënë se edhe ky segment do të asfaltohet dhe tani është duke punuar në trasenë që është kontraktuar.

3. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Planit të Punës për Ekipin Komunal për të drejtat e Fëmijës, Kamenicë për vitin 2025-2027,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-këtu e kemi një plan të punës që është i dedikuar për të drejtat e fëmijëve, ku në këtë plan të punës janë të theksuara: parimet, vlerat, qëllimet, objektivat, trajnimet e tyre, mbikëqyrjen e stafit të fëmijëve etj, a keni diskutime për këtë pikë nëse jo vazhdojmë me procedurë të votimit,

Kush është për miratimin e pikës së tretë?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

4. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, për zonën kadastrale në Bratilloc, me nr.P-71107008-000-25-0.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- në këtë seancë i kemi 7 propozime për ankand publik, po fillojmë nga pika e katërt, kjo parcela që gjendet në listën e

dhënies në shfrytëzim dhe për ata që kanë interes që t'i shfrytëzojnë për qëllime janë të parapamë edhe me planin zhvillimor komunal, janë 5 ha që gjenden në fshatin Bratilloç. A keni diskutime për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk keni e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e pikës së katërt?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

5. **Propozim vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, për parcelën me nr.P-71107008-000-25-0.**

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- këtu kemi formimin e komisionit që lidhe me pikën e 4-të ?

Nga Ekzekutivi pjese e komisionit do te jene:

- **Magbule Kastrati.....anwtar i kuvendit**
- **Lirim Kryeziu.....anwtar i kuvendit**
- **Ilirida Zubaku.....nga ekzekutivi i komunws**
- **Edon Canaj.....nga ekzekutivi i komunws**
- **Lavdim Klaiqi.....nga sektori joqeveritar lokal**

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

6. **Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, për zonën kadastrale në Kamenicë, me nr.P-71107041-01981-0.**

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- edhe kjo pronë ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim përmes ankandit publik, kjo tokë është në qytetin e Kamenicës, vendi i quajtur Qendra Trektare Zejtare, a e dëshiron dikush fjalën?

Jeton Biqkaj-çdo pronë që jepet duhet të cila pjesë jepet, për çka parashihet dhe cili është interesi i komunës ?

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës-besoj që drejtoria me material i ka dërguar edhe shpjegimet për secilën pikë, këtu bëhet fjalë për biznesin “Moe” për periudhë të shkurtër kohore. Mandej komisioni e qet vlerën e caktuar.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-a e dëshiron dikush fjalën, nëse jo e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

7. Propozim vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, për parcelën me nr.P-71107041-01981-0.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- edhe këtu e kemi një komision.

- **Rabit Dërmaku.....anwtar nga kuvendi**
- **Magbule Kastrati.....anwtare nga kuvendi**
- **Labinot Dërmaku.....anwtar nga ekzekutivi**
- **Flaviana Halili.....anwtare nga ekzekutivi**
- **Sherafedin Vranjasektori joqeveritar lokal**

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, hedhim në votim anëtarët e propozuar për këtë komision,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....**Të gjithë**

Kundër.....**0**

Abstenim.....**0**

8. Propozim vendim për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “ Ndërtimi i varrezave në fshatin Hodonoc” në mes Komunës së Kamenicës dhe participimit të Këshillit Lokal të Fshatit Hodonoc,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-këtu e kemi një propozim-vendim për krijimin e kodit të ri për projektin “ Ndërtimi i varrezave në fshatin Hodonoc” në mes Komunës së Kamenicës dhe participimit të Këshillit Lokal të Fshatit Hodonoc, komuna do të participoj prej 17 700 euro, ndërsa, ky fshat do të participojë me 4425 euro, ku projekti do të kushtojë rreth 22 mijë euro. A e dëshiron dikush fjalën, nëse jo e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....**Të gjithë**

Kundër.....**0**

Abstenim.....**0**

9. Propozim-vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm publik nën menaxhimin të AKP-së me nr. të parcelës P-71107041-01157-2,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-ky është një propozim në Kamenicë, në zonën e quajtur “ Varrezat Rome”, kjo është e evidentuar në emër të N.P.SH “ Qëndresa” dhe menaxhimin e AKP-së.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës-është një parcelë mbi rrugën ‘ Syl Zarbinca” është pronë publike por në pronësi të ndërmarrjes “ Qëndresa” e cila menaxhohet nga AKP-ja.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, a keni diskutime rreth kësaj pike, nëse nuk keni diskutime, e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....**Të gjithë**

Kundër.....0

Abstenim.....0

10. Propozim vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Solar Grenn Energy SH.P.K” me procedurë të negocimit të ofertës.

Burbuqe Leka-Drejtores për Zhvillim Ekonomik dhe Diaspor, në bazë të ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës të pronës komunale të kërkesës nga kompania “Solar Grenn Energy SH.P.K” me përfaqësues Trim Tërnavë, të datës 06.05.2025, objekti i negocimit ka qenë prona komunale për zhvillimin e projektit. Pas zhvillimit të negociatave palët janë pajtuar për dhënien në 257462 m² me kompensim. Pronat komunale objekt i negocimit janë në çarakovc, afati i dhënies së pronës me qera është 30 vite. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim është për investimi në projekte “Invetimi në panele Fotovoltaike”. Vlera e këtij projekti do të jetë 12 milion euro. Solar Grenn Energy, do të fillojë sipas planit të biznesit në afat prej 1 viti nga pajisja me leje adekuate nga ZRRE, KOSTT, komuna dhe ministritë përkatëse. Solar Grenn Energy SH.P.K në emër të kompensimit për shfrytëzimin e pronës komunale do t’i paguaj Komunës qira vjetore në vlerë 500 euro/ha nga subjektit Solar Green Energy Sh.P.K pas vitit të tretë pas dhënies në shfrytëzim të pronës komunale. Për të siguruar përmbushjen e kontratës Solar Green Energy Sh.P.K detyrohet të ofrojë një policë të sigurimit apo garancion bankar në vlerë prej 50,000.00 euro e cila do të shërbejë në rast të dështimit të projektit. Solar Green Energy Sh.P.K raporton te Komuna e Kamenicës çdo një vit mbi implementimin e kushteve për të cilat obligohen t’i përmbushë. Numri minimal i punëtorëve 10 punëtorë(një prej tyre të jetë nga personat me aftësi të kufizuara) nuk guxon të biejë poshtë në asnjë periudhë të secilit vit kalendarik pa koordinim dhe pajtim me Komunën e Kamenicës ku gjatë punësimit të ketë së paku 20% gra prej momentit që Solar Green Energy Sh.P.K dhe Komuna e Kamenicës nënshkruajnë kontratën. Do të synohet maksimalisht që punëmarrësit të jenë banorë të Komunës së Kamenicës. Sipas ligjit për sponsorizim të (sportit dhe artit) biznesi do të përzgjedhë një nga OJQ-të lokale të Komunës së Kamenicës për sponsorizim minimum në vlerë prej 20,000.00 euro në vit, pavarësisht nga qarkullimi vjetor. Solar Green Energy Sh.P.K zotohet që do të mbështes me mjete financiare aktivitetet kulturore dhe sportive të cilat organizohen nga komuna e Kamenicës si p.sh. Sumer Fest Kamenica, Ëinter Fest Kamenica etj. Solar Green Energy SH.Pk obligohet të bashkëpunojë me Shkollën profesionale për angazhimin e praktikantëve në profilet adekuate duke përkrahur edhe pagesat stimuluese nëse ato kërkohen nga komuna. Ndryshimi i destinimit të shfrytëzimit të tokës komunale nuk mund të bëhet pa miratim paraprak nga Komuna e Kamenicës. Komuna e Kamenicës miraton në tërësi projektin dhe veprimtaritë sipas Plan biznesit të projektit Solar Green Energy SH.P.K ruan të drejtën për modifikimin e veprimtarive brenda projektit sipas nevojës, kërkesës dhe rregulloreve në fuqi. Kontrata me kushtet specifike do të përpilohet dhe nënshkruhet nga palët pas aprovimit të propozimi të Kryetari në Kuvend dhe pas aprovimit të ligjshmërisë së vendimit nga ana e institucionit qendror përkatës.

Rabit Dërmaku-a mundëni me ma shpjego edhe njëherë për 257462 m² dhe qarkullimi vjetor në vlerë prej 500 euro për ha, si do të jetë kjo qera pas investimit apo ?

Burbuqe Leka-Drejtores për Zhvillim Ekonomik dhe Diaspor-pas vitit të tretë pas dhënies me qera kur të fillojnë investimet do të fillojë edhe pagesa.

Florim Kryeziu- nuk jam kundër biznesit por për dokumentacion të plotësuar se a është më Plan Zhvillimor Komunal, ju si drejtoresh a keni marrë leje të kësaj prone nga ministria e ambientit. Kjo pronë a është për panele solare ?

Burbuqe Leka-Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Diaspor- sa i përket pronës është në përputhje me investimin që do të bëhet është edhe dokumentacioni që është e lejuar kjo veprimtari. Para se me i kërkuar dokumentet për biznesin në fjalë kemi pasur takime me drejtorin e Urbanizmit se a është e planifikuar me Planin Zhvillimor Komunal.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës, tokat e kategorive të 5,6 dhe 7-të janë të pranueshme për këto investime e sidomos për energji solare mundet edhe pa procedurë me vazhduar por ne për shkak që me u siguruar që kuvendi po e jep në shfrytëzim që mendon se është i përmbushur financiar e publik. Kategoritë që janë në klasin5-të nuk hynë domosdoshmërisht në PZHK, nëse është e specifikuar për këtë veprimtari dhe ligji e specifikon se edhe pa procedurë mundesh me vazhduar përkatësisht ceket për energji solare.

Jeton Biqkaj- si projekt e mbështesim që të jepet në shfrytëzim vetëm të mos të ketë pengesa në marrjen e lejes në të ardhmen.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- nëse nuk ka diskutime të tjera e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

11. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik për parcelat me nr. P-71107041-01336-1, P-71107041-01338-0, P-71107041-01339-0, P-71107041-01335-0,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kemi katër parcela të cilat gjenden në Komunën e Kamenicës, pikërisht te vendi i quajtur tregu.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës- market ose biznesi “ Viva Fresh” për të cilën i kemi diskutuar të gjitha variantet nëse ish kërkuar periudhë më afatgjate nuk do të vihej në ankand por palës i duhet me investuar në atë pjesë në e dimë se investimi vetëm se ka ndodhur, por vazhdimi mund të ndodh vetëm nga ankandi publik për biznesin në fjalë ekzistues. Ne kemi arritur një marrëveshje jashtëgjyqësore ngase na ka paditur që e kemi shkëputur kontratën. Nëse nuk ka aplikues të tjerë të cilët mund ta sfidojnë me çmim më të lartë, me politikat që i vendos komisioni që e themelon kuvendi do t’i qetë, ato kushte, kritere minimale që duhet me i plotësuar investitori ose qiramarrësi në fjalë.

Jeton Biqkaj-a është fjala për një vend e parcela të ndara apo për pjesën e marketit? Nëse ka mundësi edhe të kemi informata lidhur me padinë që e ka bërë “ Viva Fresh”, ku janë procedurat se sa kam njohuri e di se kontratën e ka pasën për 10 vite.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës, fjala është vetëm për pjesën e marketit dhe kur të dalin në ankand ne mund të caktojmë metrat katror të cilat duhet të jepen në shfrytëzim. Procedura për “ Viva Fresh” në gjykatë është në shkallën e dytë nuk e dimë epilogun për shkallën e dytë por e kemi mundësin me qitë kritere më të favorshme që kanë qenë të cilat kanë me qenë shumë më të favorshme se sa kanë qenë. Për komunën e Kamenicës një prej kushteve kryesore do të jetë qiraja e cila do të jetë më e shtrenjtë se tani dhe përfitimet tjera për sportin dhe komunitetin do të jenë më të mira.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- nëse nuk ka diskutime të tjera e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

- 12. Propozim vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për parcelat me nr.P-71107041-01336-1, P-71107041-01338-0, P-71107041-01339-0, P-71107041-01335-0,**

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- vazhdojmë me propozime për formimin e komisionit për këtë pronë:

- **Florim Kryeziu.....anëtar i kuvendit**
- **Magbule Kastrati.....anëtar i kuvendit**
- **Edon Dërmaku, nga ekzekutivi i komunës**
- **Flaviana Haliti, nga ekzekutivi i komunës dhe**
- **Lavdim Klaiqi nga sektori joqeveritar lokal**

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

- 13. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik për parcelat me nr.P-71107079-00558-2 dhe P-71107079-00308-0,**

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- këtu i kemi dy parcela zona gjendet në fshatin Çarakoc, kanë një sipërfaqe të përbashkët rreth 30 mijë metra katror, në aspektin e bujqësisë, kultivimin e gjërave bujqësore. A keni diskutime për këtë pikë, nëse jo e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

- 14. Propozim-vendim për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për parcelën me nr.P-71107079-00558-2 dhe P-71107079-00308-0,**

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-vazhdojmë me propozime për komisionin për vendimin paraprak.

- **Lirim Kryeziu.....anëtar i kuvendit**
- **Magbule Kastrati.....anëtar i kuvendit**
- **Edon Dërmaku, nga ekzekutivi i komunës**
- **Flaviana Haliti nga ekzekutivi i komunës dhe**
- **Lavdim Klaiqi nga sektori joqeveritar lokal**

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

- 15. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik për parcelat me nr. P-71107074-00868-0, 03101-0, 00022-0, 00816-0, 00816-0,**

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- këtu e keni pronën në fshatin Topanicë, vendin e quajtur “ Lumi Demës” , afati për dhënien është për 5 vite, nëse nuk keni diskutime, vazhdojmë me procedurën e votimit.

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

- 16. Propozim vendim për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për parcelën nr. P-71107074-00868-0, 03101-0, 00022-0, 00816-0, 00816-0,**

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- vazhdojmë me propozimet e për formimin e komisionit.

- **Selim Maliqi.....anëtar i kuvendit**
- **Magbule Kastrati.....anëtar i kuvendit**
- **Edon Dërmaku.....nga ekzekutivi i komunës**
- **Flaviana Haliti.....nga ekzekutivi i komunës dhe**
- **Lavdim Klaiqi.....nga sektori joqeveritar lokal**

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....14

Kundër.....0

Abstenim.....0

- 17. Propozim- vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “ Veton Kallaba B.I” me procedurë të negocimit të ofertës,**

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- a keni diskutime për këtë pikë, nëse jo vazhdojmë me procedurën e votimit,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....14

Kundër.....0

Abstenim.....0

- 18. Propozim-vendim për formimin e komisionit të ankesave,**

Rabit Dërmaku-kur kam lexuar për këtë komision thuhet se afati i komisionit është dy vjet, ndërsa mandati jonë është edhe 6 muaj dhe këtu nuk po mundem me e kuptuar.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kush dëshiron që të jetë pjesë e këtij komisioni?

- **Egzona Isufi**.....anëtare e kuvendit
- **Donjeta Ismajli**.....anëtare e kuvendit
- **Arben Hoxha**anëtar nga ekzekutivi i komunës
- **Ramush Ismajli**.....anëtar nga ekzekutivi i komunës
- **Sherafedin Vranja**..... Sektori joqeveritar lokal

19. Kërkesë për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr.8623 për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kjo ishte miratuar në mbledhjen e kuvendit por për shkak të vonimit të një dokumenti nga pronari, ministria e ka rikthyer si të kundërligjshme edhe pse i kemi dërguar dokumentin por ishim dy ditë me vones. A keni diskutime për këtë pikë, nëse jo e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

20. Kërkesë për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr.8628, i VSM e Planeve Nderkomunale per menaxhimin e Integruar të mbeturinave për Komunitet e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Hani i Elezit, Shtërpçë-Kosovë.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kemi edhe dy propozime ku për gjitha komunat është rikthyer për rishqyrtim, që i njëjti plan të shfuqizohet deri në harmonizimin e një planit tjetër për arsye që 30 ditëshi që është kriter është i paarritshëm. Nëse nuk keni diskutime e hedhim në votim,

Kush është për shfuqizimin e kësaj pike ?

Për.....të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

21. Kërkesë për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr. 8627 i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajit,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-edhe kjo pikë kërkohet që të shfuqizohet, a keni diskutime për këtë pikë nëse jo e hedhim në votim,

Kush është për shfuqizimin e kësaj pike ?

Për.....të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

22. Propozim për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “ Ndërtimi i Trafostacionit me Sn⁴400 kVA, në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit të Avdullah Muharrem Bajra” Shiqkos-Aralco”
Sh.A

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës-po flasim për fabrikën e ujit “ Kika “pas një sërë takimesh me menaxhmentin e lartë të KEDS përfaqësuesit e kompanisë kemi arritur që të gjejmë gjuhën e përbashkët të bashkëpunimit ku inxhnierët e kompanisë KEDS, kanë përgatitur planin investiv për trase e cila ka një kosto totale prej 68,623.00€, ku Komuna e Kamenicës do të participojë me 80%, kurse kompania me 20% . sigurisht se vlerën e saktë do ta përcaktojnë edhe ofertat pas zhvillimit të procedurave të prokurimit, ky rrjet në parim nuk i shërben vetëm kompanisë të gjithë zonës se e ka një gjatësi të madhe për me arrit me prodhues lokal e vendor duhet krijimi i një kodi të ri. Marrëveshjen e kemi nënshkruar, nëse pajtoheni edhe ju për zgjidhjen afatgjatë, kërkoj mbështetjen.

Kush është për miratimin e kësaj pike ?

Për.....të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

23. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-jemi tek pika në të ndryshme a e dëshiron dikush fjalën nëse jo me kaq e përmbyllim seancën.
Mbledhja përfundon në ora 11:10

Procesmbajtëse


Sabile Arifi

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës



Liridon Kastrati



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.230, datë 20.06.2025

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja d), neni 13, neni 17, paragrafi 1, shkronja b), neni 40 dhe 58, shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008), në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.1 dhe neni 6, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.1, lidhur me nenin 10, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, nenin 11 dhe nenin 15 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013), Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor, Vendimin SP-02 Nr. 1129-3/25, datë 05.06.2025, nga MMPHI për dhënien e pëlqimit për “Planin Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033”, si dhe neni 5, paragrafi 5.1, shkronja b), nenin 38, paragrafi 38.1 dhe neni 70, paragrafi 70.1, shkronja h) të Statutit 01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2025 sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033

Neni 1

MIRATOHET “Plani Zhvillimor Komunal” për Komunën e Kamenicës për periudhën 8 (tetë) vjeçare 2025–2033” (në tekstin e mëtejme PZhK), si një dokument i planifikimit hapësinor multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor, duke përfshirë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për tërë territorin e Komunës së Kamenicës, me sipërfaqe të përgjithshme prej ($S = 4,166,323.74 \text{ m}^2$), $S = 416.624 \text{ km}^2$.

Neni 2

- 2.1.** “Plani Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033” përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tërë territorin e komunës, mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Kamenicës.
- 2.2.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është “Plani Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033” i hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Kamenicës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2023, dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor, dhe i miratuar me Vendimin SP-02 Nr. 1129-3/25, datë 05.06.2025, për dhënien e pëlqimit për “Planin Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033” nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

2.3. “Plani Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033” përmban pjesën tekstuale dhe pjesën hartografike, Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Raportin e Shqyrtimit Publik, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi. Të gjitha këto janë të përkthyer në gjuhën serbe.

Neni 3

Të gjitha dokumentet tjera komunale të planifikimit hapësinor, që nuk janë në kundërshtim me “Planin Zhvillimor Komunal të Kamenicës 2025–2033”, mbesin në fuqi deri në miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Kamenicës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjitha organet e Komunës së Kamenicës, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Bashkëngjitur këtij vendimi është: Vendimi SP-02 Nr. 1129-3/25, datë 05.06.2025, nga MMPHI për dhënien e pëlqimit për “Planin Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033”, Kërkesa Sh.02.Nr.15240, datë 19.06.2025 e parashtruar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal në Kamenicë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr. 10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në web-faqen zyrtare të komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. protokoli Sh.01 nr. 06-15525, datë 08.05.2014, për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2013–2023+.

Vendimi t’i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe QSHQ- arkivit.


Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Nr. i Proje. 01
Dok. i Proje. 02
Niveli i Proje. 02
Titulli i Proje. 02
Niveli i Proje. 02

Nr. i Prot. 3852-2/20
Prot. No. 3852-2/20
Data: 12.06.25
Datum: 12.06.25

PRISHTINË / A

Për:	Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës Liridon Kastrati, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Detyrë në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër në Detyrë në MMPHI Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Shendrita Latifi – Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit dhe Mbështetjes Ligjore
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr. 10794 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kamenicës, datë 30.04.2025

I nderuar kryetar Rahimaj,
I nderuar kryesues Kastrati

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 13.05.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 01 Nr. 10794 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kamenicës, datë 30.04.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Kamenicës:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimi 01 Nr. 10794 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kamenicës, datë 30.04.2025.

ARSYETIMI

MMPHI pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Përcaktimi i lokacionit për shfrytëzimin e një zone apo nën-zone të caktuar sipas këtij Vendimi duhet të bazohet në dokumentet e planifikimit hapësinor të Komunës së Kamenicës. Një pjesë e pandashme e këtij vendimi duhet të jetë edhe pjesa tekstuale, si dhe pjesa hartografike e dokumentit në fuqi, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, mbi të cilin është bazuar ky vendim.

Për këtë arsye, inkurajojmë Komunën e Kamenicës që të përmbyllë sa më parë procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal Komunal (PZHK) dhe Hartës së Zonale të Komunës (HZK), në mënyrë që kërkesat e tilla të adresohen në mënyrë të qartë dhe të saktë në këto dokumente të planifikimit hapësinor.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.227, datë 17.06.2025

Në bazë të nenit 13 paragrafit 2, shkronja d), nenit 24 paragrafit 1 dhe 2, neni 40 paragrafit 2, shkronja b) dhe c) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Neni 60 të Ligjit Nr.03.L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në përputhje Qarkoren Buxhetore 2026/1 me numër të protokollit 1508/2025 e lëshuar me datë 15.05.2025 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe nenit 38, paragrafi 38.1, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h) dhe neni 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2025, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Kamenicës 2026-2028

1. Me këtë vendim **MIRATOHET** Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) Sh.06,NR.13470 e dates 03.06.2025 e Komunës së Kamenicës për periudhën 2026-2028:

Fondi Burimor	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Grandi I Përgjithëshëm	6,452,896.00	5,742,213.00	6,196,672.00
Grandi I Arsimit	5,688,769.00	5,859,432.00	6,035,215.00
Grandi I Shëndetësisë	2,019,522.00	2,080,107.00	2,142,510.00
Shërbimet Sociale			
Rezidenciale	220,000.00	200,000.00	200,000.00
Të hyrat Vetanake	1,223,917.00	1,315,257.00	1,321,154.00
TOTALI	15,605,104.00	15,197,009.00	15,895,551.00

Kategorit Ekonomike	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Paga dhe Mëditja	10,022,200.00	10,022,200.00	10,022,200.00
Mallëra dhe Shërbime	2,440,411.00	2,440,411.00	2,440,411.00
Shpenzime Komunale	262,000.00	265,500.00	269,650.00
Subvencione dhe Transfere	930,000.00	930,000.00	930,000.00
Shpenzimet Kapitale	1,950,493.00	1,538,898.00	2,233,290.00
TOTALI	15,605,104.00	15,197,009.00	15,895,551.00

2. Pjesë përbërse e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) Sh.06,NR.13470 e dates 03.06.2025 e Komunës së Kamenicës për periudhën 2026-2028.
3. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Financa dhe Buxhet ,kurse për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës .
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Kamenicë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008”), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.


Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

REFERENC-Ë:					
PËR/ZA/TO:			Kryetarin e Komunës - z. Kadri Rahimaj Kryesuesin e Kuvendit Komunal-z .Liridon Kastrati		
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:			Drejtores e DFB-së - znj. Ardita Dërmaku		
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:			KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2026-2028		
Nr. i Zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. Kancelarije:		Lokacija:		Datum:	02.06.2025
Room No:		Extencion:		Date:	
Për aktivitet/Za aktivnost/For action/					
Për miratim/Za ushvanje/For aprova/				X	
Për nënshkrim/Za potpis/ For signature/					
Për komente/Za komentare/For comments/					
A mund të diskutojmë/Dali možemo raspravljati/ May we discuss/					
Vëmendja e juaj/ Vaša pažnja/Your attention/					
Sipas diskutimit/Kako je raspravljeno/As discussed/					
Siç është kërkuar/ Kako je zatraženo/As requested/					
Shënim dhe përgjigje/ Beleška i odgovor/ Note and retur/					
Për informimin tuaj/ Za vašu informaciju/ For your information/					
Afati/ Rok/Deadline/					

Të nderuar,

Komunat janë të obliguara të përgatisin Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, si dokument bazik i nivelit të lartë strategjik Komunal, i cili pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike, për të përmbushur objektivat e përcaktuara me strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Kuvendi Komunal shqyrton dhe aprovon Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB), e publikon në faqen zyrtare të komunës dhe një kopje dorëzohet në Departamentin e Buxhetit në MF deri me datë 30.06.2025.

- Zyrtari Kryesor Financiar harton Draftin e KAB-it komunal ,më pas Kryetari e dorëzon në Kuvend Komunal për diskutim Publik
- Konsultimet do të mbahen me komunitetin dhe palët kyçe të përfshira, përfshire këtu takimet publike për të diskutuar lidhur me prioritet dhe strategjinë e Komunës.
- Kuvendi Komunal shqyrton dhe Aprovon KAB-Komunale
- KAB-I komunal I aprovuar publikohet dhe një kopje dorëzohet në Departamentin e Buxhetit Komunal/MF



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAMENICËS DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

Periudha 2026 – 2028

Dokument strategjik për orientimin dhe konsolidimin financiar të
Komunës së Kamenicës.



Qershor 2025

Kamenicë

Përmbajtja:

I. Hyrja

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

III. Korniza Fiskale

- 3.1 Korniza makroekonomike komunale
- 3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2026-2028
- 3.3 Donatorët e jashtëm
- 3.4 Politikat e reja
- 3.5 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2026-2028
- 3.6 Buxheti i Përgjegjshëm Gjinnor 2026-2028

IV. Korniza e Performancës së Shpenzimeve

V. Buxheti i Përgjegjshëm Gjinnor/BPGJ/


I. Hyrja

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) që po prezantojmë, është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale dhe paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti vjetor 2026. Ky dokument siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike bazuar edhe në analizë gjinore dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028 siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilëve, realizohen objektivat me prioritet, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor. Me Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, do të paraqesim objektivat dhe aktivitetet duke u bazuar në identifikimin e nevojave të grave dhe burrave gjatë planifikimit nga aspektet e shpenzimit të buxhetit në paga, politika të punësimit, përfituesëve të bursave, subvencionet, pjesëmarrja në dëgjime publike, duke promovuar rritjen e mirëqenies sociale, ku në fokus të jenë grupet në nevojë dhe promovimi nga aspekti barazisë gjinore.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet komunale të kërkuar nga Qarkorja Buxhetore Komunale 2026/01 e lëshuar nga Ministria e Financave me dt.15.05.2025 si pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), dhe është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2026-2028, të dhëna nga Ministria e Financave (MF), përmes Qarkores buxhetore 2026/01 për komunat, si dhe financimi nga grantet qeveritare dhe kufijtë fillestarë të

buxhetit komunal për vitin 2026 dhe parashikimet për periudhën 2027-2028, që janë miratuar nga Komisioni i granteve i miratuar 15 maj 2025.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve me prioritet të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2026-2028. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore 2026-2028

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet buxheti vjetor për vitin vijues 2026. Qëllimi kryesor i përcaktimit të prioriteteve është që të bëhet ndërlidhja e planifikimit buxhetor në përputhje me Objektivat Strategjike Komunale 2026-2028. Korniza Afatmesme Buxhetore për periudhën 2026-2028, planifikohet në bazë të buxhetit, i cili bazohet në Buxhetin e programeve, në objektivat dhe në deklaratat e misioneve të programeve. KAB-ja komunale 2026-2028, është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores buxhetore nr. 2026/01. Në KAB-in komunal paraqiten edhe deklaratat dhe misionet e drejtorive lidhur me punën e tyre pasuese trevjeçare. Gjatë përgaditjes dhe dorëzimit të kërkesave të tyre buxhetore për vitin 2026 dhe parashikimet (2027-2028) nga Drejtoritë e caktuara tregojnë se si plani i tyre buxhetor i përgjigjet prioriteteve të Komunës të paraqitura më poshtë.

Zhvillim ekonomik lokal i komunës përfshin informata dhe sfida lidhur me fushat si më poshtë:

1. **Spektori i Arsimit:** Avansimi dhe përmirësimi i cilësisë së arsimit, avansim të kapaciteteve në planifikim strategjik dhe monitorim, përmirësimi i cilësisë në menaxhim të arsimit dhe mësimdhënies, renovime apo paisje me inventar si dhe investime në infrastrukturë

aty ku nevojitet si dhe teknologji, Ndërtimi i qerdheve të reja dhe funksionalizimi i qerdheve të sapoperfunduara ,Të sigurojmë ushqim të shëndetshëm për fëmijët në qerdhe;Renovimet e objekteve arsimore,Të digjitalizohet i gjithë sistemi arsimor komunal;Të bëhet vlerësimi i performancës së shkollave

informative bashkohore.

- **Sektori i Infrastrukturës:** Rritja e hapësirave gjelbëruese në komunën e Kamenicës,Mirëmbajtja e Hapësirave të hapura publike në baze të planit për mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike; Mirëmbajtja e rrugëve lokale në komunën e Kamenicës, (rritja e buxhetit);Zgjerimi i rrjetit 100% në fushën e mbeturinave;Mirëmbajtja e infrastrukturës;Përmirësimi në furnizimin me ujë;Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësve në lokalitete të ndryshme;Përfundimi i punimeve të bulevardit në qendër, me gjithë infrastrukturën përcjellëse;Mirëmbajtjen dhe menaxhimin e hapësirave të gjelbra komunale në qytet, Menaxhimin e lokacioneve për deponimin e materialeve të ngurta,Sinjalizimi vertikal dhe horizontal, Mirëmbajtja dhe menaxhimi i parkingjeve publike në qytet,Menaxhimi i mbeturinave të ngurta dhe familjare,

Sektori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: Ruajtja e shëndetit publik, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, përmirësimi i infrastrukturës në shëndetësi, rritja e nivelit të kualifikimit të stafit, ruajtja e trendeve për furnizim me aparatura shëndetësore etj.

Sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:, parandalimi i ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore, shtimi i kapaciteteve për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore, mbrojtja dhe plasmani i produkteve bujqësore, përmirësimi i teknologjisë të përdorur nga bujqit, kapitali i pamjaftueshëm financiar, qasje të pamjaftueshme në fonde zhvillimore etj.

Sektori i Ekonomisë dhe Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore:

Përmirësimi i ambientit biznesor dhe tërheqja e investimeve të reja. Krijimi i qendrës për zhvillimin e sektorit privat- Ofrimi i Praktikes në punë për të rinjtë, studente, Rritja e mbështetjes financiare për praktikante ,Monitorimi, mbikëqyrja- menaxhimi e Parkut Teknologjik për shfrytëzimin e hapësirave ndarja e zyrave);Planifikimi dhe përpilimi i listave të pronave të paluajtshme të komunës për publikim për dhënie në shfrytëzim në bashkëpunim me drejtorinë për pronë.,Implementimi dhe përmbushja e objektivave të parapara në Strategjinë për zhvillim ekonomik lokal- Përmes komisionit të monitorimit Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit dhe promovimi i prioriteteve dhe potencialeve të pasurive natyrore/nëntokësore të komunës. Promovimi i potencialeve për zhvillimin e turizmit, Vazhdimi i Shënjëzimit të shtigjeve malore për ecje dhe digjitalizimi i tyre;Vazhdimi i Shënjëzimit të shtigjeve malore për ecje dhe digjitalizimi i tyre;Bashkëpunime me donatorë për realizimin e projekteve të turizmit;Vendosja e Hartave turistike në tre lokalitete brenda Komunës- Lugu i verdhe, Qytet dhe Roganë,Adaptimi i objekteve komunale të pashfrytezuara në bujtina malore,Ndërtimi i qendrave të viewpoint në tri lokacione


III. Korniza Fiskale Komunale


3.1 Korniza makroekonomike komunale

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon (shih tabelën më poshtë). Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2026-2028 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.


Aktualisht financimi komunal përfshinë: **të hyrat vetanake, grandet qeveritare** që janë pjesë integrale e e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2026-2028 .Nga ky aspekt i KAB-it, Komuna e Kamenicës ka pësuar reforma progresive të financimit edhe atë te Grandi i Arsimit. Të gjitha parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për grandet qeveritare për financim të komunave për vitin 2026-2028 si dhe pjesëmarrja e buxhetit komunal janë në përputhshmëri me Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal. Komunitat nga viti në vit kan një shkallë të rritur të decentralizimit fiskal dhe të transparenës. Komunitat kanë kompetenca dhe fleksibilitet në shpenzime të të hyrave vetanake.

Pjesëmarrja e Grandeve në totalin e grandit qeveritar 2026.






Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2024-2028



Paraqitja Grafike e Buxhetit te Komunes se Kamenices për vitet 2024-202



Duke analizuar trendin e planifikimit për tri vitet e ardhshme (2026-2028) Grandet Qeveritare për Komunën e Kamenicës kanë një rritje prej 1.64% sidomos kjo është reflektuar te Grandi i Arsimit/rritje/ prej 4.69% dhe Grandi i Shëndetësisë/zvoglim/ prej 3.47%. dhe Grandi Specifik për Shërbime Sociale Rezidenciale është I njejtë me vitin 2025 .

Të hyrat vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2024-2028

Të hyrat komunale të Komunës së Kamenices realizohen në bazë të Ligjit mbi financat e pushtetit lokal, Rregullores mbi tarifat dhe ngarkesat komunale, Rregullores mbi tatimin në pronë, si dhe dispozitave tjera ligjore, të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale, me të cilat Komuna ka të drejtë të caktojë dhe arkëtojë të hyra të tjera komunale. Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë tatimi në pronë dhe të hyrat tjera , të cilat të hyra shpenzohen në fushën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime të tjera, gjë që ju kthehen qytetarëve (tatimpaguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës publike komunale.

Të hyrat tatimore


Për vitin 2026 planifikohet një rritje e planifikimit të Tatimit në Pronë në krahasim me vitin 2025.Ne periudhen afatmesme ka nje rritje prej 10.98%

TE HYRAT TATIMORE									
2024		2025		2026		2027		2028	
Tatimi ne Prone	Tatimi ne Toke	Tatimi ne Prone	Tatimi ne Toke	Tatimi ne Prone	Tatimi ne Toke	Tatimi ne Prone	Tatimi ne Toke	Tatimi ne Prone	Tatimi ne Toke
490,421.00	103,474.00	438,943.00	103,170.00	481,693.00	120,667.00	516,615.00	146,007.00	521,782.00	146,737.00


Të hyrat jo-tatimore parashihet të kenë një rritje mesatare prej 10.24% në periudhën afatmesme.

TE HYRAT jo TATIMORE									
2024		2025		2026		2027		2028	
422,726.00		591,960.00		621,557.00		652,635.00		652,635.00	
								110.249848	

Paraqitja Grafike e të hyrave tatimore për vitet 2024-2028



Paraqitja Grafike e të hyrave jo tatimore për vitet 2024-2028



Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale, për vitin 2026-2028

Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale, për vitin 2026-2028					Komuna e Kamenices		653	
Nr.	Përshkrimi	Realizimi 2022	Realizimi 2023	Realizimi 2024	Planifikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
1	Tatimi në pronë	538,405.60	445,498.45	198,355.38	438,943.00	481,693.00	516,615.00	521,782.00
2	Tatimi në tokë	61,964.12	150,494.52	101,780.51	103,170.00	120,667.00	146,007.00	146,737.00
3	Licencat dhe lejet	1,388.70	-	7,926.30	1,500.00	1,550.00	16,000.00	16,000.00
4	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	47,041.00	45,887.85	29,875.00	54,930.00	86,421.00	75,000.00	75,000.00
5	Taksat e pajisjeve motorike	69,270.00	-	77,700.50	67,000.00	67,500.00	67,500.00	67,500.00
6	Lejet per ndertesa	47,421.07	84,192.10	21,616.00	61,800.00	76,947.50	70,000.00	68,000.00
7	Taksat tjera komunale	139,021.79	85,306.25	120,396.10	73,800.00	80,000.00	119,956.00	71,000.00
8	Taksat për Mbeturinat							
9	Ngarkesat rregullatore							
10	Te hyrat nga qiraja	47,130.39	41,677.31	34,247.60	40,000.00	56,000.00	58,000.00	51,000.00
11	Bashke-pagesat per arsim	32,445.00	48,362.00	47,950.00	45,000.00	45,000.00	52,000.00	40,000.00
12	Bashke-pagesat per shëndetësi	55,477.80	58,737.40	63,371.80	56,000.00	56,000.00	50,000.00	57,000.00
13	Ngarkesat tjera komunale	12,834.77	79,984.00	7,926.30	95,000.00	15,000.00	108,122.00	14,000.00
14	Shitja e aseteve				5,000.00	5,000.00		5,000.00
15	Të hyrat nga gjykatat		400.00	9,315.00	3,200.00	3,500.00	3,500.00	3,500.00
16	Të hyrat nga gjobat në trafik	162,314.00	140,308.10	207,668.00				
17	Të hyrat nga Agjencioni Pyjor i Kosovës	350.00	44,668.65	16,317.84				
18	Të hyrat tjera	35,832.92	115,574.37	22,379.57	88,729.00	128,638.50	32,557.00	184,635.00
Total		1,250,897.16	1,341,091.00	966,825.90	1,134,072.00	1,223,917.00	1,315,257.00	1,321,154.00

2.1 Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë)

Të prezantohet trendi i pjesëmarrjes së donatorëve të huaj (përmes garantëve) për vitet 2023-2025 në buxhetin e komunës si dhe parashikimi afat-mesëm i kontributit tyre dhe projektet që planifikohet të mbështeten si financim komplet i donatorit apo me bashkë-pjesëmarrje.

Kodi i projektit	EMRI I PROJEKTIT	2024	2025	2026	2027	Total
18391	Rregullimi i rrugeve ne Malesin e Kamenices, Asfaltimi rruges Feriqev-Gjyryshevc,	500,000.00	500,000.00	547,992.00		1,547,992.00
18443	Ndertimi i Bulevardit te qytetit ne Kamenice	460,457.00	223,235.00			683,692.00
18779	Ndertimi i shkolles fillore F Noli Kamenice	1,000,000.00	1,000,000.00	950,000.00	1,000,000.00	3,950,000.00
19060	Ndertimi I qerdhes ne fshatin Koretin	100,000.00	100,000.00	235,000.00		435,000.00
19408	Ndërtimi i urës në fshatin Hodonc, Komuna e Kamenicës	200,000.00	150,000.00			350,000.00
16192	Rregullimi i infrastrukturës në rrugën kryesore dhe tranzitin e qytetit, Kamenicë	300,000.00	300,000.00	292,114.00		892,114.00
16193	Asfaltimi i rrugës "Mihajl Grameno", Kamenicë	86,118.00	57,172.00			143,290.00
19363	Ndërtimi I rrugëve pëgjatë brezit kufitar: segmenti Sforcë (Kapi) - Zhujë - Shahiq - Lisockë dhe Segmenti : Dragoc-Sedllar-Kranidell, KK Kamenicë	1,200,000.00	1,200,000.00	2,200,000.00	2,300,000.00	6,900,000.00
19383	Asfaltimi i rrugës Poliqkë - Desivojcë, KK Kamenicë	800,000.00	800,000.00	1,000,000.00		2,600,000.00
19245	Ndertimi i stadiumit ne Hogosht, Kamenice	500,000.00	500,000.00			1,000,000.00
16129	Xhamia në Meshinë, Meshinë, Kamenicë	31,000.00	31,000.00			62,000.00
16139	Shtëpia Banimi në Leshtarë (Jusuf Ademi), Kamenicë	72,000.00	72,000.00			144,000.00
16140	Shtëpia e Rahim Sadikut (Shtëpia ku u strehua Mulla Idrizi), Gjyrishec, Kamenicë	168,000.00	168,000.00			336,000.00
15541	Ndërtimi I sallës së sportit në Kamenicë	100,000.00	150,000.00	200,000.00		450,000.00
19235	Shtegu I Atletikes ne Kamenice	500,000.00	500,000.00	1,300,000.00	1,670,000.00	3,970,000.00
15627	Kompleksi Rexhep Malaj Kamenice	50,000.00	50,000.00			100,000.00

19125	Renovimi I gjimnazit Ismajl Qemali -Kamenice	250,000.00	250,000.00			500,000.00
19220	Asfaltimi I xhades se vjeter Berivojce-Topanice Koretin	228,613.00	228,613.00			457,226.00
19484	Rruga qarkore Kamenice K1 Komuna e Kamenices	200,000.00	200,000.00	200,000.00		600,000.00
19485	Asfaltimi I rruges Korca -Gmice Komuna e Kamenices	150,000.00	150,000.00	100,000.00		400,000.00
19486	Asfaltimi I rruges Berivojce-Koretin (nga Lagja Ibrahim Komuna e Kamenice	135,000.00	135,000.00	100,000.00		370,000.00
19668	Zgjerimi dhe rehabilitimi I rrugeve Kolloleq-Dajkoc-Muciverc 5.2 Km		200,000.00	500,000.00	800,000.00	1,500,000.00
19669	Ndertimi I rruges qarkore ne Kamenice Krahu K-2 1065 Km		100,000.00	200,000.00	300,000.00	600,000.00
19677	Asfaltimi I rrugeve Livadheve ,Zajqeci,Mahmuti,dhe Ahmeti Kamenice		200,000.00	500,000.00	600,000.00	1,300,000.00
19646	Ndertimi I impiantit per trajtimin e mbeturinave organike ne Kamenice		180,000.00			180,000.00
		7,031,188.00	7,445,020.00	8,325,106.00	6,670,000.00	29,471,314.00

IV. Korniza e Performancës së Shpenzimeve

4.1 Kapitulli i Performancës Programore mund të hartohet në konsultim dhe me kontributin e drejtorëve / menaxherëve kryesorë të programeve. Prezantimi i thjeshtë por gjithëpërfshirës i aspekteve kryesore të performancës duhet të kryhet për programet kryesore.

- Lidhja me prioritetet politike strategjike;
- Renditja e objektivave programore;
- Skicimi i matjeve specifike të performancës;
- Paraqitja e resurseve totale buxhetore.

Tabelat e mëposhtme janë paraqitur si ilustrim rreth prioritetëve strategjike të dalura nga synimet e drejtorive në planifikimin afatmesëm dhe lidhja me të paktën një objektiv të performancës për secilin departament.

V. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor

Që nga viti 2015, Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) është obligim ligjor për të gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës, ato të nivelit lokal si dhe të nivelit qendror. Konkretisht, Neni 5.1.5 i Ligjit 05/L-020 mbi Barazinë Gjinore, kërkon që të gjitha institucionet e Kosovës të sigurojnë: “Përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e resurseve”.

Buxheti gjinor synon të analizojë çdo formë të shpenzimeve dhe të të ardhurave publike nga një perspektivë gjinore, domethënë identifikon implikimet e ndryshme, që kanë shpenzimet dhe të ardhurat publike të gratë dhe vajzat, si dhe grupet e ndryshme të grave, krahasuar me burrat dhe djemtë. Objektivi final i buxhetit gjinor është të formojë buxhete në atë mënyrë që ato të promovojnë, aktivisht, barazinë gjinore.


Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) është strategji për integrimin e perspektivës gjinore në planifikimin ekonomik dhe në Buxhetin Komunal. Me të synohet që të përvetësohet një perspektivë për përmirësimin e barazisë së grave dhe burrave në bazë të një analize gjinore në secilën fazë të planifikimit, programimit, dhe realizimit të buxheteve Komunale. Andaj, një buxhet i këtillë nuk duhet të shihet si buxhet shtesë, por si një mënyrë më e mirë e planifikimit buxhetor, bazuar në informata specifike për të dy gjinitë, të cilët janë përfitues të politikave dhe buxheteve të ndryshme. Bazuar në këtë analizë, qëllimet strategjike drejt përforcimit të barazisë gjinore mund të përfshihen në politika dhe buxhete. Kjo mund të ndihmojë në rritjen e transparencës, në rritjen e efektivitetit të shpenzimeve publike, dhe të lehtësojë monitorimin e zbatimit të tyre. Procesi i planifikimit sipas BPGJ-së në Komunën e Kamenicës është organizuar në faza:

- Faza I: Analiza e buxhetit sipas perspektivës gjinore
- Faza II: Ristrukturimi i buxhetit i bazuar në analizë gjinore
- Faza III: Integrimi i perspektivës gjinore si një kategori analitike në proceset buxhetore


Tabela e përfituesve për subvencione për vitin 2024

Pershkrimi	Numri total i perfituesve	Shqiptar	Serb/Rom	Numri I perfituesve Gra	Numri I perfituesve Burra	% perfituesve Gra	% perfituesve burra	Shuma e perfituesve gra	Shuma e perfituesve burra
Bujqesia	423	399	24	41	382	9.03	90.97	27,914.05	258,643.25
ZLK	19		19	13	6	68.42	31.58	2,700.00	1,450.00
Ceshtja Gjinore	12	12		7	5	58.33	45.45	1,798.00	3,200.00
Ekonomia	72	72		22	50	30.56	76.39	29,180.00	87,630.00
Sherbimet Kulturore	78	78		36	42	46.15	57.69	11,120.00	13,390.00
OJQ	2054	2036	18	338	1716	16.46	83.54	27,743.84	145,085.91
Arsimi	350	350		186	164	53.14	46.86	40,630.00	40,440.00
TOTALI	3,008	2,947	61	643	2365	21.38	78.62	141,085.89	549,839.16


Grafiku i shpërndarjes të subvencioneve për OJQ sipas Strukturës Gjimore për Komunën e Kamenicës



Grafiku i shpërndarjes të subvencioneve nga struktura gjimore për Komunën e Kamenicës




Grafiku i shpërndarjes të subvencioneve nga shuma e perfituesve gjinore për Komunen e Kamenices



Regjistri i takimeve për dëgjime buxhetore për vitin 2025-2027

Janë mbajtur gjithësejtë 25 dëgjime buxhetore ,numri I pjesemarrësve 514.Nga ky numer 468 eshte numri I pjesemarrësve meshkuj dhe 46 numri I pjesemarrësve femer.

Paraqitja Grafike e pjesëmarrjes së burrave dhe grave në dëgjime buxhetore



Objektivat e Komunës së Kamenicës për BPGJ për vitet 2026-2028

Objektivat e Komunës së Kamenicës për BPGJ për vitet 2026-2028					
	Numri i përfituesëve 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026	Buxheti 2027	Buxheti 2028
OBJEKTIVI 1: Punësimi më shumë gra nëse egzistojnë vende te lira					
Indikatori Gjinor 1. Nëse egzistojnë vende të lira punë,përqindja e grave të punësuarra të rritet	454	5%	5%	5%	5%
Indikatori Gjinor 2. Avansimi në detyrë I punonjësve gra	8	30%	30%	30%	30%
OBJEKTIVI2.Më shumë gra të përfitojnë makineri dhe pajisje /farëra/					
Indikatori Gjinor 1. Të rritet numri i grave përfituese të makinerisë dhe të pajisjeve ,farëra, pleh, qumësht, serra duke inkurajuar gratë për të aplikuar dhe potencialisht duke ofruar pikë më të larta për gra aplikuese	29	15%	20%	20%	30%
Indikatori Gjinor 2. Të rritet numri i aplikuesëve të grave në subvencionime në fushën të bujqësisë	37	20%	20%	25%	25%
Indikatori Gjinor 3. Të rritet numri I grave per pjesëmarrje në trajnime në sektor të ndryshum në kuadër të bujqësisë	3	10%	10%	25%	25%
OBJEKTIVI3. Mbështetja e bizneseve dhe start up përmes granteve dhe subvencioneve në bashkëpunim me organizata dhe donator					
Indikatori Gjinor 1. Përfshirja e grave në aftësim profesional	6	100%	50%	100%	150%
Indikatori Gjinor 2. Stimulim për regjistrim të bizneseve nga gratë dhe lirimi nga taksa komunale për dy vitet para të themelimit		10%	15%	15%	15%

Indikatori Gjinor 3. Të rritet numri I grave për pjesëmarrje në trajnime ,këshillime dhe sesione informuese	20%		20%	20%	20%
Indikatori Gjinor 4.Krijimi I hapësirave rekreative/shtigjet malore për ecje/, për gra dhe burra	1 km	3 km	4 km	5 km	6 km
Indikatori Gjinor 5.Krijimi I kushteve për gra amvise qe ushqimet e tyre tradicionale të iu ofrojnë bujtinave malore me pagesë.					
Indikatori Gjinor 6.Krijimi I kushtëve më të përshtatshme për burra dhe gra për plasimin e prodhimeve të tyre në treg përmes Tregut të gjelbërt gjithëditor					
Indikatori Gjinor 7.Ofrimi I mundësisë të djemve dhe vajzave praktikë me pagesë në punë	23	37	20%	20%	20%

	OBJEKTIVI. 4 Subvencionimi i OJQ-ve të përfaqësuara nga Gratë				
Indikatori Gjinor 1. Të rritet numri i grave përfituese për OJQ	338	10%	10%	10%	15%

	OBJEKTIVI.5 Përfshirja e Grave dhe burrave në Dëgjime Publike				
Indikatori Gjinor 1. Të rritet numri i grave pjesëmarrëse në dëgjime publike nga vitet paraprake	28	46	75%	75%	80%
Indikatori Gjinor 2. Të rritet numri I propozimeve në dëgjime publike nga gratë	3	5	10	15	20

Indikatori Gjinor 3. Të shqyrtohen propozimet e grave dhe të bashkangjiten në listën e projekteve për vitet në vijim	1	3	100%	150%	200%
Indikatori Gjinor 4. Të rritet numri I grave për të aplikuar dhe potencialisht duke ofruar pikë më të larta për gra aplikuese gjatë procedurave të tenderimit			1%	2%	2%
Indikatori Gjinor 5. Një analizë nga propozimet e qytetarëve nga dëgjimet buxhetore në baza gjinore në përfshirjen në regjistrin e projekteve kapiatle					
Indikatori Gjinor 5. Të organizohet një anketim për mospjesëmarrjen e grave në dëgjime publike duke përfshirë Fshatrat dhe Qytetin E Kamenicës			2	2	2
	OBJEKTIVI. 6 Subvencionimi i të rinjëve dhe të rejave				
Indikatori Gjinor 1. Të rritet numri I subvencionimit të burrave për bursa	77	70%	75%	75%	80%
Indikatori Gjinor 2. Të rritet numri I përfituesëve për subvencione për kategori të reja sipas rregullorës së brendshme të subvencioneve		10%	10%	10%	10%
Indikatori Gjinor 3. Të subvencionohen gratë lehona me pako për lindje		100%	100%	100%	100%
	OBJEKTIVI. 7 Subvencionimi I kategorive të caktuara për ndihma momentale				
Indikatori Gjinor 1. Subvencionimi i grave dhe burrave për ndihma momentale	808	15%	20%	25%	25%
Indikatori Gjinor 2. Të subvencionohen kategorite e caktuara me aftësi të kufizuara /Hendikos,Shoqata e te verbërve,Kryqi I Kuq	370	10%	10%	10%	10%

	OBJEKTIVI. 8 Fushata e re për Buxhetim Gjinor nga praktikat dhe përvojat e fituara nga takimet dhe punëtori			
Indikatori Gjinor 1. Organizimi i takimeve ,sesioneve informuese, trajnimeve dhe punëtorive me punëtor të Administrates për BPGJ		20	50	150
Indikatori Gjinor 2. Të organizohen punëtori me bashkëpunim me komuna tjera në nivel regjioni duke shkëmbyer përvoja ndërkomunale për BPGJ/		4	6	10

Tabela e buxhetit per vitet 2024-2028

	2,024	2,025	2,026	2,027	2,028	Diferenca 1	Progresi	Progresi	Progresi
							1	2	3
							2026- 2025	2027- 2026	2028- 2027
Numri I Punetoreve	1,140	1,154	1,111	1,111	1,111	(43)	96	100.00	100.00
Grandi I pergjitheshem	5,976,303.00	6,452,896.00	6,452,896.00	5,742,213.00	6,196,672.00	-	100.00	88.99	107.91
Grani I Arsimit	5,440,648.00	5,433,969.00	5,688,769.00	5,859,432.00	6,035,215.00	254,800.00	104.69	103.00	103.00
Grandi I shendetesise	1,892,973.00	2,041,687.00	2,019,522.00	2,080,107.00	2,142,510.00	(22,165.00)	98.91	103.00	103.00
Sherbimet sociale rezidenciale	197,272.00	220,000.00	220,000.00	200,000.00	200,000.00	-	100.00	90.91	100.00
Total Grandet	13,507,196.00	14,148,552.00	14,381,187.00	13,881,752.00	14,574,397.00	232,635.00	101.64	96.53	104.99
te hyrat vetanake	1,016,621.00	1,134,072.00	1,223,917.00	1,315,257.00	1,321,154.00	89,845.00	107.92	107.46	100.45
Totali	14,523,817.00	15,282,624.00	15,605,104.00	15,197,009.00	15,895,551.00	322,480.00	102.11	97.38	104.60
Paga dhe meditja	8,980,426.00	9,185,435.00	10,022,200.00	10,022,200.00	10,022,200.00	836,765.00	109.11	100.00	100.00
Mallra dhe sherbime	2,274,272.00	2,422,098.00	2,440,411.00	2,440,411.00	2,440,411.00	18,313.00	100.76	100.00	100.00
Shpenzime komunale	254,000.00	262,000.00	262,000.00	265,500.00	269,650.00	-	100.00	101.34	101.56
Subvencione	648,000.00	885,000.00	930,000.00	930,000.00	930,000.00	45,000.00	105.08	100.00	100.00
Investime Kapitale	2,367,119.00	2,528,091.00	1,950,493.00	1,538,898.00	2,233,290.00	(577,598.00)	77.15	78.90	145.12
TOTALI	14,523,817.00	15,282,624.00	15,605,104.00	15,197,009.00	15,895,551.00	758,807.00	102.11	97.38	104.60

Stafi:

Bazuar në Qarkoren buxhetore 2026/01 dhe në instruksionet e dhëna për komunën e Kamenicës ,për vitin 2026 kemi një shkurtim të stafit sipas tabelave dhe shënimeve nga Qarkorja 2026/01.

- Nga tabela e të dhënave statistikore dhe shpërndarja e grantit specifik për arsimin parauniversitar për vitet 2026-2028 kolona ndryshim të stafit kemi zvoglim prej 50
- Politikat e reja nga Komisioni I Grandeve te kolona numri I personelit ndihmes per cerdhet e reja 2026 kemi nje rritje te stafit prej 3
- Nga tabela Granti specifik për Shëndetësi primare për vitet 2026-2028 te kolona politikë e re në fëmijëri të hershme aprovuar nga Komisioni I Grandeve kemi nje rritje te stafit prej 4 edhe ate /Logoped,Psokolog,fizioterapeut,punëtor social/.

Në total stafi për Komunën e Kamenicës per vitin 2026 do te jete 1,111

Paga dhe shtesa

Kategoria e shpenzimeve për **paga dhe shtesa** planifikohet të **rritet 9.11% gjatë vitit 2026**. Pjesëmarrja e kategorisë për Paga dhe meditje në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës,gjatë vitit 2026 do të jetë 62.45% Për kalkulimin e pagave për vitin 2026 është marrë për bazë:

Pagat dhe mëditjet:Bazuar nga Qarkorja 2026/01 Komuna ka palnifikuar ne baze te :

1. Pages sipas muajit Mars 2025 bazuar ne 12 muaj
2. Rritja nga muaji korrik ne shume prej 55.00€
3. Pozitat e pa plotesuar bazuar nga paga mesatare e Kosoves dhe nga shuma e kalkuluar 40% te buxhetit
4. Rregullorja komunale per sistematizim te vendeve te punes

4.3.2Mallrat dhe Shërbimet / Kategoria e mallrave dhe shërbimeve pritet të rritet me një mesatare prej 0.76% në periudhën afatmesme. Pjesëmarrja e kategorisë për mallra dhe shërbime në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës,gjatë vitit 2026 do të jetë 15.64% , krahasuar me vitin 2025 ka një rritje të lehtë prej 0.76% .Kjo rritje është bazuar në rritje të cmimeve për furnizime dhe shërbime.

4.3.3 Shpenzimet Komunale / Në bazë të kufijve të caktuar nga KAB-I për vitin 2026-2028 del se komuna e Kamenicës ka bërë planifikimin e buxhetit me rritje për shkak të shpenzimeve të mëdha, sidomos kategoria për rryme(rritja e energjiëse elektrike) ngase ka shpenzime në ndriçime publike sepse kemi shtrirje të rrjetit të ndriqimit publik në fshatra dhe qytet.Pjesëmarrja e kategorisë për shpenzime komunale në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës ,për vitin 2026do të jetë 1.68% , ndërsa krahasuar me vitin 2025 është e njejtë..

4.3.4 Subvencionet / Në bazë të kufijve të caktuar me KAB-I për vitin 2026-2028 del se komuna e Kamenicës ka një planifikim të buxhetit të rritur krahasuar me vitin 2025.Kemi kërkesa për subvencionim për biznese të ndryshme dhe aktivitetet e planifikuara nga Grupi i grave dhe Drejtoria për ekonomi, kërkesa për subvencionim edhe në përkrahje të bujqëve të komunës, subvencionimi në Drejtorinë për KRS për aktivitetet vjetore /manifestimet/ dhe përkrahje klubeve të ndryshme,kemi Marëveshje për shpenzime të varrimit ,Aprovimi me ndryshim Rregullores së re dhe kostoja financiare e rritur sidomos shpenzimet e varrimit nga 100.00 në 230.00€ dhe kostoja tjetër për gratë lehona ,shpërblime në fushën e Arsimit.Pjesëmarrja e kategorisë për subvencione në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës gjatë vitit 2025 do të jetë 5.96%,ndërsa krahasuar me vitin 2025 ka rritje prej 5.08%.

4.3.5 Projektet Kapitale / Në bazë të kufijve të dalur nga KAB-I për vitin 2026-2028 del se Komuna e Kamenicës ka një planifikim të buxhetit më ultë krahasuar me vitin 2025 ka një zvoglim prej 22.85 % apo (577,598.00) €..Pjesëmarrja e kategorisë për Investime kapitale në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës, gjatë këtij viti 2026 do të jetë 12.50% .

RREZIQET AFATMESME 2026-2028

Korniza bazë e paraqitur në KAB përcillet si çdo vit me rreziqe, të cilat mund ta ndryshojnë Pasqyrën dhe strukturën e shpenzimeve të planifikuara gjatë realizimit. Krahësuar me vitin e kaluar, rreziqet vazhdojnë të jenë të evidente kryesisht me origjinë nga Rastet Gjygjësore/Detyrimet Kontigjente/Të Arkëtueshmet/Detyrimet e papaguara dhe Memorandumet e nënshkruara .

- **Rreziku nga detyrimet kontigjente që rrjedhin nga kontrata kolektive në**

Arsim - Në plan afatmesëm si masë shtesë që duhet të ndërmerret në funksion të menaxhimit të këtyre rreziqeve është përfshirja në planifikim të Ligjit të Buxhetit si ndarje buxhetore për mundësi të keqklasifikimit dhe ndryshimit të strukturës kategorive ekonomike. Sipas Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2024, Detyrimet Kontigjente për Komunën tonë arrijnë në 1,133,507.35€ euro. Lëvizjet e këtyre detyrimeve nga viti 2022 kanë një rritje prej 30.27%. Në vitin 2024, pagesat e bazuara në vendimet e gjykatave përbënin 15.96% të shpenzimeve aktuale të organizatave buxhetore në shumë prej 2,505,262.00. euro nga shuma totale e shpenzimit 15,693,066.30€.

- **Rreziku fiskal nga mbledhja e të hyrave-** Një rrezik i rëndësishëm fiskal i lidhur me të hyrat tatimore është se a mund të mbledhen tatimet e arkëtueshme apo jo. Sipas Pasqyrave vjetore financiare për vitin 2024, llogaritë e arkëtueshme të pa mbledhura për Komunën tonë arrijnë në 2,063,718.74 euro. Trendet e rritjes në krahasim me vitin 2023 për vitin 2024 janë 28.41% më shumë. Arsyeja e tjetër është edhe një realizim i ulët i të hyrave tatimore për shkak të faljes në shumë prej 100€ të gjithë obliguesit tatimor të aprovuar në Kuvendin Komunal.

- **Memorandum bashkëpunimi lidhur në mes të Komunës dhe Ministrive** –Komuna e Kamenicës ka të nënshkruara Memorandume të ndryshme për projekte të caktuara me Ministri të ndryshme .Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2025– dhe parashikimit 2025-2027 kemi projekte të cilat paraqesin rrezik për devijim të planifikimit të buxhetit komunal .Në obligimet e Komunës përmendet Komuna duhet të I ndërmerret të gjitha masat që projekti të përfundojë në përputhje me ndarje buxhetore .Projektet janë shumëvjeqare dhe ndarjet e buxhetore sipas Memorandumeve prej vitit në vit kanë ndryshuar me Ligj të Buxhetit ndërsa OE kryen punët sipas planit dinamik .

- **Nën ekzekutimi investimeve kapitale**

Projektet e pa përfunduara për shkak të vonësive në realizimin e tyre sipas planit dinamik dhe anulimeve të kontratave paraqet rrezik potencial të ekzekutimit të kësaj kategorie dhe humbjen e mjeteve të planifikuara për vitin aktual në fund të vitit kalendarik .Këto projekte do të plotësohen me bartjen e mjeteve nga të hyrat e bartura.

Tabela e buxhetit 2026

Programi	Stafi	Paga	Mallra dhe Sherbime	Shpenzime Komunal	Subvencione	Invest Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	29	295,000.00	250,000.00		250,000.00		795,000.00
Zyra e Kuvendit Komunal	27	255,000.00	10,000.00				265,000.00
Administrata dhe Personeli	35	280,000.00	180,000.00				460,000.00
Ceshtja Gjimore	1	8,100.00	5,000.00		10,000.00		23,100.00
Buxhet dhe Financa	25	241,000.00	20,000.00				261,000.00
Ekonomi dhe Diaspore	5	50,000.00	42,000.00		170,000.00		262,000.00
Infrastruktura Publike	20	203,000.00	400,000.00	165,000.00			768,000.00
Zjarrefikset dhe Inspektimet	33	335,000.00	45,000.00				380,000.00
ZLK	7	60,100.00	5,000.00		10,000.00		75,100.00
Bujqësi dhe Pylltari	9	78,000.00	35,000.00		160,000.00		273,000.00
Kadaster dhe Xheodezi	11	110,000.00	10,000.00				120,000.00
Urbanizem	10	107,000.00	50,000.00				157,000.00
Investimet Kapitale	6	80,000.00	70,000.00				150,000.00
Administrata -Shendetësi	4	41,000.00	40,000.00				81,000.00
Sherbimet e shendetësisë Primare	165	1,742,000.00	260,000.00	32,000.00			2,034,000.00
Sherbimet sociale	13	115,000.00	15,000.00				130,000.00
Sherbimet sociale rezidenciale	11	160,000.00	75,000.00	10,000.00			245,000.00
Sherbimet Kulturore	18	140,000.00	70,000.00		110,000.00		320,000.00
Perkrahja e Rinise	3	50,000.00	20,000.00		20,000.00		90,000.00
Administrata-Arsim	12	119,000.00	631,650.00	55,000.00	200,000.00		1,005,650.00
Arsimi Parashkollor	49	403,000.00	65,000.00				468,000.00
Arsimi Fillor	468	3,900,000.00	90,000.00				3,990,000.00
Arsimi I Mesem	150	1,250,000.00	51,761.00				1,301,761.00
TOTALI	1111	10,022,200.00	2,440,411.00	262,000.00	930,000.00	1,950,493.00	15,605,104.00

Tabela e buxhetit 2027

Programi	Stafi	Paga	Mallra dhe Sherbime	Shpenzime Komunal	Subvencione	Invest Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	29	295,000.00	250,000.00		250,000.00		795,000.00
Zyra e Kuvendit Komunal	27	255,000.00	10,000.00				265,000.00
Administrata dhe Personeli	35	280,000.00	180,000.00				460,000.00
Ceshtja Gjimore	1	8,100.00	5,000.00		10,000.00		23,100.00
Buxhet dhe Financa	25	241,000.00	20,000.00				261,000.00
Ekonomi dhe Diaspore	5	50,000.00	42,000.00		170,000.00		262,000.00
Infrastruktura Publike	20	203,000.00	400,000.00	168,500.00			771,500.00
Zjarrefikset dhe Inspektimet	33	335,000.00	45,000.00				380,000.00
ZLK	7	60,100.00	5,000.00		10,000.00		75,100.00
Bujqësi dhe Pylltari	9	78,000.00	35,000.00		160,000.00		273,000.00
Kadaster dhe Xheodezi	11	110,000.00	10,000.00				120,000.00
Urbanizem	10	107,000.00	50,000.00				157,000.00
Investimet Kapitale	6	80,000.00	70,000.00				150,000.00
Administrata -Shendetësi	4	41,000.00	40,000.00				81,000.00
Sherbimet e shendetësisë Primare	165	1,742,000.00	260,000.00	32,000.00			2,034,000.00
Sherbimet sociale	13	115,000.00	15,000.00				130,000.00
Sherbimet sociale rezidenciale	11	160,000.00	75,000.00	10,000.00			245,000.00
Kulture rini dhe sport	18	140,000.00	70,000.00		110,000.00		320,000.00
Perkrahja e Rinise	3	50,000.00	20,000.00		20,000.00		90,000.00
Administrata-Arsim	12	119,000.00	631,650.00	55,000.00	200,000.00		1,005,650.00
Arsimi Parashkollor	49	403,000.00	65,000.00				468,000.00
Arsimi Fillor	468	3,900,000.00	90,000.00				3,990,000.00
Arsimi I Mesem	150	1,250,000.00	51,761.00				1,301,761.00
TOTALI	1111	10,022,200.00	2,440,411.00	265,500.00	930,000.00	1,538,898.00	15,197,009.00

Tabela e buxhetit 2028

Programi	Stafi	Paga	Mallra dhe Sherbime	Shpenzime Komunali	Subvencione	Invest Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	29	295,000.00	250,000.00		250,000.00		795,000.00
Zyra e Kuvendit Komunal	27	255,000.00	10,000.00				265,000.00
Administrata dhe Personeli	35	280,000.00	180,000.00				460,000.00
Ceshtja Gjimore	1	8,100.00	5,000.00		10,000.00		23,100.00
Buxhet dhe Financa	25	241,000.00	20,000.00				261,000.00
Ekonomi dhe Diaspore	5	50,000.00	42,000.00		170,000.00		262,000.00
Infrastruktura Publike	20	203,000.00	400,000.00	172,650.00			775,650.00
Zjarrefikset dhe Inspektimet	33	335,000.00	45,000.00				380,000.00
ZLK	7	60,100.00	5,000.00		10,000.00		75,100.00
Bujqësi dhe Pylltari	9	78,000.00	35,000.00		160,000.00		273,000.00
Kadaster dhe Xheodezi	11	110,000.00	10,000.00				120,000.00
Urbanizem	10	107,000.00	50,000.00				157,000.00
Investimet Kapitale	6	80,000.00	70,000.00				150,000.00
Administrata -Shendetësi	4	41,000.00	40,000.00				81,000.00
Sherbimet e shendetësise Primare	165	1,742,000.00	260,000.00	32,000.00			2,034,000.00
Sherbimet sociale	13	115,000.00	15,000.00				

							130,000.00
Sherbimet sociale rezidenciale	11	160,000.00	75,000.00	10,000.00			245,000.00
Kulture rini dhe sport	18	140,000.00	70,000.00		110,000.00		320,000.00
Perkrahja e Rinise	3	50,000.00	20,000.00		20,000.00		90,000.00
Administrata-Arsim	12	119,000.00	631,650.00	55,000.00	200,000.00		1,005,650.00
Arsimi Parashkollor	49	403,000.00	65,000.00				468,000.00
Arsimi Fillor	468	3,900,000.00	90,000.00				3,990,000.00
Arsimi I Mesem	150	1,250,000.00	51,761.00				1,301,761.00
TOTALI	1,111	10,022,200.00	2,440,411.00	269,650.00	930,000.00	2,233,290.00	15,895,551.00



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



ZYRA E KRYETARIT

Misioni

Deklarata e misionit:

Realizon mbikëqyrjen e përgjithshme të administrimit financiar të Komunës, kujdeset për zbatimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, përfaqëson Komunën, zbaton të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës, kujdeset për zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe Statutit të Komunës, për gatit propozime për çështje të caktuara që janë në interes të përgjithshëm të Komunës

Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e LVL-së dhe Statutit të Komunës, është përgjegjës të:

1. Përfaqësojë Komunën dhe të veprojë në emër të saj;
2. Udhëheqë ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj dhe të mbikëqyrë administrimin financiar të Komunës;
3. Ushtrorë të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
4. Ekzekutojë aktet e Kuvendit të Komunës;
5. Emërojë dhe shkarkojë zëvendësin e tij/saj;
6. Emërojë dhe shkarkojë drejtorët, të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
7. Organizojë punën dhe të drejtojë politikën e Komunës;
8. Propozojë rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;
9. Propozojë zhvillimin komunal, planet rregulluese dhe investuese, të propozojë buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe të ekzekutojë buxhetin e miratuar;
10. Raportoë para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomike – financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së paku një herë në gjashtë muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës;
11. Kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsiderohet se akti bie në kundërshtim me legjislacionin në zbatimin, apo interesin e komuniteteve;
12. Mbikqyrë administrimin e përgjithshëm financiar

13. Delegojë përgjegjësi te anëtarët e Këshillit të Drejtorëve dhe të mbikqyrë zbatimin e përgjegjësi

Nënkryetari: Deklarata e misionit: Organizon koordinimin e punës me komitetet e fshatrave dhe bashkësi, mbikëqyrë marrëdhëniet me publikun, koordinon oraret me mediat elektronike dhe të shkruara, zëvendëson kryetarin në rast të mungesës së tij.

Spektori i auditimit të brendshëm- Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga tre auditorë. Kjo njësi gjatë vitit fiskal, kryen disa auditime nëpër drejtoritë komunale. NJAB-ja ka për mision të kontrollojnë ecurinë e punëve dhe shërbimeve të cilat ofrohen në organizatën tonë buxhetore. Qëllimi i tyre është që të ngrihet niveli i performancës së Komunës. Në kuadër të misionit të saj, njësia e auditimit të brendshëm: - siguron zbatimin adekuat dhe respektimin e ligjeve, rregulloreve, politikave, udhëzimeve dhe doracakeve; - siguron përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të planeve për auditim të brendshëm; - organizon, kryen dhe mbikqyrë ushtrimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe dorëzon rezultatet e auditimit para Komisionit të auditimit; - përgatit dhe dorëzon raporte tremujore dhe vjetore mbi të gjitha aktivitetet e auditimit të NJAB-së te Komisioni i auditimit; - kryen auditime të brendshme në pajtim me rregullat, politikën, doracakët, udhëzimet dhe standardet profesionale të nxjerra nga organet qendrore dhe lokale, në pajtim me legjislacionin në fuqi; - shqyrton të gjitha të dhënat teknike, ekonomike dhe financiare, si dhe informatat e dokumentit në posedim ose kontroll të subjektit në auditim; - kopjon të dhënat, informatat apo dokumentet për qëllime të auditimit të brendshëm dhe siguron që kopjet në fjalë të jenë origjinale ose të vërtetuara; - mund të kërkojë nga cilido zyrtar, punonjës, këshilltar që të ofrojë dëshmi fizike, shënime ose dëshmi gojore, ose informata të tjera mbi qështjet që kanë të bëjnë me auditimin ose mbi aktivitetet që janë në auditim; ka qasje pa pengesë në stabilimentet e subjektit në auditim, dhe verifikon dhe vlerëson vlerat materiale dhe monetare të subjektit, në pajtim me rregullat dhe legjislacionin në fuqi; - propozon masat që duhet të ndërmerren nga subjekti përkatës; - merr informata të certifikuara nga Thesari, BPK-ja dhe cilado organizatë publike apo private në lidhje me xhirollogarinë aktuale apo të mbyllur; - për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të Komunës; - kryen edhe punë të parapara sipas ligjit, Statutit të Komunës së Kamenicës dhe rregulloreve në fuqi, si dhe vendimeve dhe urdhërave të Kryetarit të Komunës.

Spektori i burimeve njerëzore - Spektori i burimeve njerëzore ushtron kompetenca në përputhje me autorizimet, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet ligjore që i përkasin në funksion të zbatimit të kërkesave ligjore të dispozitave të Ligjit për shërbimin civil, Ligjit të punës dhe akteve të brendshme të Komunës; Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka, bën: - vlerësimin dhe miraton kërkesat për plotësimin e vendeve të punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mundësi Buxhetore të Komunës; - hartimin dhe shpalljen e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira, në përputhje me ligjin dhe procedurat në fuqi; - propozimin e komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për plotësim të vendeve të lira, në përputhje me ligjin dhe procedurat; - hartimin e vendimeve dhe formën e kontratave për kandidatët e përzgjedhur; - iniciimin e procedurës disiplinore ndaj nëpunësve civilë, në rastet e shkeljeve të detyrave të punës dhe shkeljeve të tjera të kodit të mirësjelljes, me kërkesë të zyrtarit kompetent; - zbatimin e pezullimit parandalues, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi; - përkujdesje për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në kuadër të Komunës së Kamenicës, në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi; - krijimin, kultivimin dhe ruan relacionet e bashkëpunimit me zyra dhe asociacione që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat dhe obligimet e nëpunësve civilë dhe publikë; - hartimin dhe kujdeset për evidencën e punëtorëve -shërbyesve civilë të drejtorive të administratës komunale, në përputhje me rregullat dhe procedurat e legjislacionit në fuqi; - bashkëpunon me të gjitha drejtoritë komunale; - kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushëveprimtarisë së Spektorit. Njësia e personelit udhëhiqet nga udhëheqësi/menaxheri i Personelit, i cili rekrutohet nga Kryetari i Komunës, në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe procedurat për legjislacionin civil; Udhëheqësi/menaxheri i Personelit dhe zyrtarja e lartë për punën e tij/saj, i raporton Kryetarit të Komunës.

Spektori për integritet evropian - Spektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe qytete, ushtron kompetenca në përputhje me autorizimet, përgjegjësitë dhe të drejtat dhe detyrimet ligjore dhe kërkesave të Kryetarit të Komunës. Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka, ky sektor: - ofron mbështetje profesionale dhe teknike për Kryetarin e Komunës, në krijimin dhe fuqizimin e marrëdhënieve me vende dhe qytete të vendeve të tjera; - kujdeset për organizimin dhe përgatitjet teknike të vizitave zyrtare jashtë vendit; - kujdeset për organizimin dhe përgatitjet teknike të pritjeve zyrtare brenda vendit; - kujdeset për organizimin dhe përgatitjet teknike të takimeve dhe konferencave rajonale dhe ndërkombëtare, të iniciuara nga Komuna e Kamenicës; - ofron informata

dhe dokumente të nevojshme për aktivitetet ndërkombëtare të Kryetarit të Komunës; - ruan, mirëmban dhe sistemon dokumentacionin mbi marrëdhëniet ndërkombëtare të Komunës së Kamenicës me vende dhe qytete të vendeve të tjera; - kujdeset për shkëmbimin e informacioneve, dhuratave dhe letërkëmbimeve të Kryetarit të Komunës me personalitet ndërkombëtare; - përgatitë materiale të nevojshme për nevojat e Komunës, për çështjet që lidhen me integrimet evropiane; - hulumton programe të ndryshme të asistencës së BE – së, që ofrojnë mbështetje për qeverisje dhe zhvillim lokal; - kryen edhe punë të tjera, me kërkesë të Kryetarit të Komunës dhe në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë-veprimtarisë së Sektorit.

Spektori për komunikim me publikun - ushtron kompetenca në përputhje me kërkesat e Kryetarit të Komunës. Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka: - merr pjesë në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës, brenda dhe jashtë Komunës; - përcjellë mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve, të komiteteve dhe të Kuvendit të Komunës; - koordinon ndërlidhjen me shtypin vendor dhe atë ndërkombëtar, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive dhe zyraqe të tjera; - koordinon zhvillimin dhe zbatimin e akteve komunale për komunikim me publikun; - ofron informata për politikat e zhvillimit të Komunës; - mbikqyrë zbatimin e Strategjisë për komunikim me qytetarë dhe administron Kodin e mirësjelljes së zyrtarëve për komunikim, për të mbajtur standarde të larta etike për zyrtarët për komunikim; - siguron transparencë dhe qasje publike për punën e drejtorëve të administratës komunale, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale, duke u ofruar informata dhe dokumente qytetarëve dhe medieve; - informon publikun për vendimet që merr Kuvendi, me anë të konferencave dhe lëshimit të kumtesave për shtyp; - mban lidhje me shtypin lokal dhe mediet elektronike për çështjet që u takojnë organeve të Komunës; - siguron informacione brenda Komunës dhe është në bashkëpunim të përherëshëm me drejtorët e drejtorive dhe shërbyesit civilë të punësuar në drejtoritë e administratës; - shoqëron përfaqësuesit e medieve brenda Komunës dhe regjistron deklaratat e zyrtarëve komunalë dhënë përfaqësuesve të medieve; - seleksionon dhe arkivon shkrimet e gazetave që kanë të bëjnë me Komunën; - kryen edhe punë të parapara me ligj, Statutin e Komunës së Kamenicës dhe me rregulloret tjera.

Spektori ligjor i Komunës - në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka: - ofron ndihmë juridike, këshillime dhe bën ekspertizë për nevojat e Kabinetit të Kryetarit, drejtorive, sektorëve/njësiqe dhe të institucioneve të arsimit, të shëndetësisë dhe të ndërmarrjeve komunale; - shqyrton të gjitha projekt rregulloret që propozuesit ia dërgojnë për miratim Këshillit të Drejtorëve, Komiteteve Kompetente dhe Kuvendit të Komunës, duke garantuar pajtueshmëri me ligjet ekzistuese në fuqi dhe Statutin e Komunës; - shqyrton propozimet e vendimeve dhe akteve të tjera që i propozohen Kuvendit për miratim; - harton vendime dhe urdhëresa administrative, të kërkuara nga Kryetari i Komunës; - ruan dokumentacionin e Zyrës ligjore dhe bën shtypjen e të gjitha materialeve dhe akteve të tjera nga përgjegjësiqa e kësaj zyreje; - bashkëpunon me bashkëpunëtorët profesionalë dhe iu ndihmon atyre në aspektin ligjor në përgatitjen e vendimeve dhe akteve tjera juridike, si dhe të materialeve tjera të ndryshme; - përfaqëson dhe mbron interesin e Komunës dhe të institucioneve që financohen nga Komuna në procedurat gjyqësore civile, penale, përmbauese dhe administrative në gjykatat e vendit në të gjitha nivelet; - ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për mbrojtjen e interesit pasuror dhe juridik të Komunës, në përputhje me përgjegjësiqtë e përcaktuara me ligj; - kryen edhe punë të tjera, të parapara me ligj, me Statutin e Komunës së Kamenicës dhe me rregullore të tjera.

Spektori i prokurimit - aktivitetin, kompetencat dhe përgjegjësiqtë i ushtron në kuadër të Ligjit (në fuqi) për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, akteve dhe autorizimeve të autoritetit kontraktues-Kryetarit të Komunës, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi; Spektori i prokurimit dhe zyrtari i prokurimit, në kuadër të obligimeve, autorizimeve dhe përgjegjësiqeve ligjore dhe duke hyrë në raporte kontraktuale me fondet publike dhe burimet publike, obligohet që ato t'i përdorin në mënyrën më ekonomike, duke marr parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Spektori i prokurimit, aktivitetin e saj në fushën e prokurimeve e bazon në parimet e ekonomizimit dhe të transparencës, si dhe në atë të barazisë në trajtim të mosdiskriminimit dhe efikasitetit të ushtrimit të aktiviteteve të prokurimeve. Komuna e Kamenicës (si autoritet kontraktues) obligohet, me këtë edhe departamenti/Spektori i prokurimit, që në fushën e menaxhimit, shfrytëzimit, organizimit dhe deponimit në burimet publike dhe fonde publike në fushën kontraktuale të punëve publike në interes për Komunën e Kamenicës, siguron dhe është përgjegjës që: - të gjithë operatorët ekonomik t'i trajtojë në mënyrë të barabartë dhe pa kurrfarë diskriminimi (si dhe pa kurrfarë favorizimi) dhe të veprojnë me transparencë të plotë, në të gjitha fazat e prokurimit. Në këtë cilësi zyrtari i prokurimeve obligohet dhe është përgjegjës që të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomik të interesuar në procedurat e tenderimit; - të bëjë publikimin e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit, në

përputhje me ligjin; - të sigurojë dhe eliminojë çdo tendencë të dhënies së kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë apo favorizojnë një apo më shumë operator ekonomik; - të sigurojë që të gjitha specifikacionet teknike të precizohen paraprakisht dhe me saktësinë më të madhe të mundshme, duke përfshirë të gjitha kërkesat dhe kriteret, si dhe metodat e përzgjedhjes së dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës; - konkursit të projektimit në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe në dosjen e tenderit, dhe që asnjë kërkesë, kriter apo specifikim që nuk është saktësuar, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes dhe të dhënies së kontratës me fondet publike në Komunën e Kamenices; - të mbajë evidencën për tërë procesin e prokurimeve, prej fillimit të aktivitetit të prokurimit e deri në dhënien e kontratës; - në përputhje me ligjet dhe procedurat në fuqi, palës së interesuar (operatorit ekonomik) t'i ofrojë qasje të drejtpërdrejtë në të gjitha të dhënat lidhur me një aktivitet të prokurimit, përveç informacioneve sekrete afariste; - autoritetit kontraktues, është personi i vetëm i autorizuar për lidhjen dhe nënshkrimin e një kontrate publike në emër të autoritetit kontraktues (Komunës), pas plotësimit të gjitha kushteve të parapara ligjore. - Zyrtari i prokurimit është shërbyes civil dhe përgjigjet sipas dispozitave të Ligjit për shërbimin civil të Kosovës dhe largohet sipas procedurave të parapara me këtë ligj. - Sektori i prokurimit ushtron edhe funksione të tjera administrative në bazë të ligjeve në fuqi dhe akteve tjera nënligjore, si dhe në bazë të vendimeve apo urdhërësive të Kryetarit të Komunës, të cilit i përgjigjen me raporte periodike 3-mujore dhe vjetore. - Kryen edhe punë të parapara me ligj, Statutin e Komunës së Kamenices dhe me rregulloret në fuqi.

TRENDET E FINANCIMIT 2026 DHE VLERËSIMET 2027-2028

	2024	2025	2026	2027	2028
Zyra e Kryetarit	Shpenzuar	Buxheti	Vlerësuar	Vlerësuar	Vlerësuar
STAFI	28	29	29	29	29
Paga dhe Meditja	246,322.11	272,585.49	300,000.00	300,000.00	300,000.00
Mallra dhe shërbime	158,932.75	200,000.00	250,000.00	250,000.00	250,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere	301,676.40	250,000.00	250,000.00	250,000.00	250,000.00
Shpenzime kapitale	320,255.24	204,196.00			
TOTALI	1,027,186.50	926,781.49	800,000.00	800,000.00	800,000.00
Burimet e Financimit			-	-	-
Grandet Qeveritare	741,082.82	726,781.49			
Te hyrat vetanake	286,103.68	200,000.00			



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



ZYRA E KUVENDIT TË KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit:

Deklarata e misionit:

Duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, ligjet në fuqi, Statutin e Komunës, rregulloret, udhëzimet e Kuvendit të Komunës, Zyra e Kuvendit duhet:

1. të ofrojë zbatimin e tyre në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase;
2. të organizojë punën e Kuvendit të Komunës, duke planifikuar buxhetin dhe kujdeset përmenaxhimin optimal të tij;
3. kryen punët administrative dhe profesionale, duke përfshirë këtu edhe punët teknike për organizimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, komiteteve dhe komisioneve punuese të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu edhe përpilimin e projekt akteve që i procedohen për miratim këtyre organeve;
4. të kryejë punë të tjera për të gjitha organet e administratës, duke përfshirë këtu pranimin e shkresave të ndryshme, dorëzimin dhe ekspeditivin e shkresave zyrtare, vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimin, punët e arkivit dhe ekspeditivit.

Deklarata e vizionit:

Duke menaxhuar me buxhetin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, konform vendimit të Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit dhe duke u bazuar në dispozitat e ligjeve në fuqi, duke përfshirë këtu edhe vendimet e Kuvendit të Komunës, angazhohet që qytetarëve të komunës t'u ofrohen shërbime sa më të mira dhe më të shpejta, konform detyrave dhe përgjegjësisë të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu lëshimin e dëshmimeve për anëtarët e Kuvendit të Komunës, përpilimin e vendimeve të Kuvendit, ekspeditivin e akteve zyrtare e materialeve për nevojat e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, bën përpunimin administrativ-teknik të akteve dhe lëndëve, arkivimin e lëndëve etj..

Deklarata e qëllimit:

Qëllimi i punës së kryesuesit të Kuvendit është që, duke e njohur nevojën për të sjellë vendimmarrjen më afër qytetarëve, të promovojë qeverisje të mirë dhe kushte të jetesës për të gjithë qytetarët e komunës, duke avancuar një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale dhe të përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve publike në Komunën e Prishtinës. Me një menaxhim sa më të mirë të punës së Kuvendit, të organizojë sa më mirë punën e personelit të shërbimit profesional të Kuvendit, me menaxhim optimal të buxhetit të saj, të krijojë kushte për punë efikase dhe transparente të Kuvendit të Komunës dhe të trupave të tij, në mënyrë që qytetarëve, në bazë të kompetencave tona, t'u ofrohen shërbime në afatet e parapara me ligj, me pretendim që këto afate të jenë sa më të shkurtra

TRENDET E FINANCIMIT 2026 DHE VLERËSIMET 2027-2028

Kuvendi Komunal	2024	2025	2026	2027	2028
	Shpenzuar	Buxheti	Vlerësuar	Vlerësuar	Vlerësuar
stafi	27	27	27	27	27
Paga dhe Meditja	229,873.82	245,456.82	270,000.00	270,000.00	270,000.00
Mallra dhe sherbime	5,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale					
TOTALI	234,873.82	255,456.82	280,000.00	280,000.00	280,000.00
Burimet e Financimit			-	-	-
Grandet Qeveritare	234,873.82	255,456.82			
Te hyrat vetanake					

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHËSHME

Drejtor: Arlindë Sejdiu

PRIORITETET BUXHETORE PËR VITIN 2026-2028

Deklarata e misionit:

Drejtoria e Administratës së përgjithshme kryen punë dhe detyra të parapara me legjislacionin në fuqi dhe në bazë të Udhëzimeve Administrative, përmirësimi i strukturës legjislative dhe efikasiteti praktik në implementimin e tyre, lehtësimeve të procedurave administrative, komunikim korrekt me qytetarët qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt qoftë sipas formave të sistemit elektronik, trajtimi me kohë të kërkesave të qytetarëve, profesionalizmi, paraqesin shtylla bazike përmes së cilave qytetarët absorbojnë shërbime cilësore administrative në Komunë. Një administratë funksionale dhe transparente është gjithashtu një kontribuues i rëndësishëm për legjitimitet të shtetit dhe besueshmërisë. Andaj, për të promovuar performancë më të avancuar të shërbimeve cilësore për qytetarët e Komunës së Kamenicës, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, prezanton planin dhe objektivat për vitin 2026.

Deklarata e Vizionit

Vizioni i Drejtorisë së Administratës së përgjithshme është i bazuar në këto shtylla, të cilat po i paraqesim më poshtë:

- Krijimi i hapësirës për kushte më të mira të punës,
- Thjeshtimi i procedurave për marrjen e dokumenteve
- Trajnimi i resurseve humane për ngritje të profesionalizmit,
- Ri funksionimi i aparatit të pritjes
- Funksionimin e një rampe digjitale tek dera e hyrjes në parking të Komunës,
- Mobilimi i arhivës aktive në Administratën Komunale
- Arkitektura e brendshme, projektimi dhe ndërtimi i Hollit të objektit Komunal

Deklarata e Qëllimit

Qëllimi i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është i orientuar me sa vijon:

- Ofrimi shërbimeve sa më cilësore për qytetarët
- Rritja e efikasiteti, efektivitetit dhe azhuritit në punë
- Rritja e kontrollit dhe raportimit në punë
- Transparencë maksimale
- Rritja e satisfaksionit të qytetarëve në raport me punën e Drejtorisë tonë
- Letësimi dhe ruajtja e dokumentacioneve në Administratën Komunale
- Qasja më e lehtë për qytetarët për të kryer shërbime

Gjendja e tanishme :

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka lëshuar gjithsej 8,581 dokumente të gjendjes civile gjatë periudhës janar–maj 2025, duke shënuar një rritje të ndjeshme krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo rritje reflekton përmirësimin e efikasitetit dhe përkushtimin e drejtorisë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve

Qendra për Shërbime me Qytetarë ka pranuar një numër të konsiderueshëm kërkesash gjatë këtij viti në total rreth 10505 kërkesa ndërsa të adresuara për Administratë ishin 7645. Me shtimin e stafit dhe përmirësimin e proceseve, shërbimet po ofrohen më shpejt dhe më efikas. Deri më tani, nuk janë regjistruar ankesa nga qytetarët lidhur me vonesa apo pritje në hollin e objektit, çka dëshmon përkushtimin dhe profesionalizmin e punonjësve tanë në dy sektorët më të rëndësishëm të komunës, si atë të gjendjes civile dhe të Qendres për shërbime me Qytetarë.

Në tabelën e më poshtme gjeni të bashkangjitur raportin e gjendjes aktuale të gjendjes Civile

Lloji I dokumentit	Janar	Shkurt	Mars	TM1	Prill
Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile	843	736	718	2297	928
Certifikatë lindje	415	343	350	1108	599
Certifikatë martese	229	187	161	577	261
Certifikatë vdekje	167	99	132	398	143
Aktvdekje	19	21	11	51	20
Certifikatë vendbanimi	141	156	220	517	198
Certifikatë të bashkësisë familjare	159	175	162	496	176
Certifikatë të gjendje martesore	81	41	52	174	68
Certifikatë shtetësie	24	7	11	42	3
Lëshimi i vërtetimeve të gjendjes civile nga arkivi	38	31	20	89	30
Lëshimi i dokumenteve nga arkivi i Komunës	11	6	4	21	5
Konfirmime / Vërtetime	10	6	9	25	8
Pranim Atësie	1	2	0	3	0
Deklarata për kthim të mbiemrit brenda 6 muajve	1	0	2	3	2
Procedura mbi 18 vjet regjistrim	11	3	4	18	3
Persona mbi 90 vjet	6	5	3	14	7

Përgjigje Gjykatave	3	3	1	7	8
Përgjigje divizionit të Pensioneve	1	8	1	10	0
Aplikim për fitim të shtetësisë	9	0	5	14	8
Aplikim për lirim të shtetësisë	0	0	0	0	0
Numri i qytetarëve që kanë kaluar në regjistrin qendror të gjendjes civile dhe shërbim:	2097	1775	1826	5698	2406
Totali:	2169	1832	1866	5867	2467
Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, brenda vendit :	0	0	0	0	0
Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, jashtë vendit :	17	15	10	42	37
Martestat e lidhura dhe rishkrim martese:	6	17	8	31	3
Shkurorëzimet :	2	6	0	8	1
Martestat me element të huaj :	5	8	0	13	4
Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda vendit :	0	10	5	15	2
Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit:	10	5	1	16	1
Mjete jetese	57	21	21	99	49
Vendime për korrigjime në emra personal :	1	1	0	2	1
Vendime për ndërrime në emra personal :	5	1	1	7	2
Totali:	103	84	92	279	198

Në tabelën e më poshtme gjeni të bashkangjitur raportin e gjendjes aktuale Qendrës për shërbime me qytetarë.

DAP KERKESAT	Janar	Shkurt	Mars	TM1	Prilli
Të pranuar	2	0	0	2	0
Në proces	17	12	24	50	19
Miratur	297	156	233	686	274
Refuzuar	0	0	1	1	0
Hedhur Poshte	0	0	0	0	0
Pezulluar	0	0	0	0	0
Ceduar	0	0	0	0	0
Anuluar	2	0	2	4	3
Perfunduar	1,694	1428	1478	4,600	2003
Totali	2,012	1596	1738	5,346	2299

Objektivat për vitin 2026:

- Investimi në kushtet e punës dhe ofrimin e shërbimeve cilësore-administrative për qytetarët.

1.1 Zhvillimi i Kapaciteteve dhe Inovacionit

- Trajnimi i stafit:** Organizimi i programeve të trajnimit për të përmirësuar aftësitë dhe njohuritë e punonjësve.
- Përdorimi i teknologjisë:** Integrimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit për të përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve

- Ndërtimi i hollit në objektin në Komunë

2.1 Qendra për Shërbime me qytetarët me këtë aktivitet do të ofrojë shërbime cilësore për qytetarët dhe do ti largojë pengesat burokratike dhe qytetarët ma lehtë do ti qasen shërbimeve.

2.2 Ndërtimi(mobilimi) i hollit i objektit të Komunës do të jetë model i ri i renditjes së shërbimeve ku synohet tu kursej qytetarëve kohë dhe energji, si dhe cilësia e shërbimeve dhe akomodimi nuk do t'iu mungojë.

3. Funkcionalizimi i zyrës së Kurorave.

4. Mobilimi i sallës së kuvendit Komunal

5. Digjitalizimi i Salles se Kuvendit Komunal

6. Të ndërtohet parkingu i Komunës

7. Të behet rregullimi dhe zgjerimi i parkingu dhe te behet me solar.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka një staf prej gjithsej 35 punonjësish, nga të cilët 15 janë gra dhe 20 janë burra. Bazuar ne % 42.85 gra dhe 57.15% burra.

	Stafi		Pjesemarrja ne buxhet		Totali	Pjesemarrja ne %	
	Burra	Gra	Burra	Gra			
201-400	8	6	39,043.07	18,949.15	57,992.22	61.54	46.15
401-600	11	8	49,732.64	38,242.44	87,975.08	39.13	30.43
600+	1	1	8,520.12	12,702.76	21,222.88	50	50.00
TOTALI	20	15	97,295.83	69,894.35	167,190.18	47.37	36.84

TRENDET E FINANCIMIT 2026 DHE VLERËSIMET 2027-2028

Drejtoria ADMINISTRATA	2024 Shpenzuar	2025 Buxheti	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar
Stafi	35	35	35	35	35
Paga dhe Meditja	221,327.75	231,956.20	275,000.00	275,000.00	275,000.00
Mallra dhe sherbime	195,976.26	225,000.00	180,000.00	180,000.00	180,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale	23,775.00	118,895.00			
TOTALI	441,079.01	575,851.20	455,000.00	455,000.00	455,000.00

Burimet e Financimit					-
Grandet Qeveritare	382,746.94	431,956.00			
Te hyrat vetanake	58,332.07	143,895.20			

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtores: Ardita Dërmaku

PRIORITETET BUXHETORE PËR VITIN 2026-2028

1.MISIONI

Deklarata e misionit : Drejtoria për Financa dhe Buxhet bënë menaxhimin e Buxhetit dhe Financave të Komunës, i siguron Drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhim të shpenzimeve dhe informon lidershipin komunal me aktualitetet e ndërlidhura me buxhet të komunës. Ka te punësuar gjithsejt 25 punëtor.

Drejtoria për Financa dhe Buxhet ka katër sektorë:

1. Sektori I Buxhetit

Deklarata e misionit: Sektori I buxhetit bënë përgatitjen e buxhetit Brenda afateve kohore të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe prezentimin e buxhetit në KPF për aprovim dhe mirëmbanë gjitha llogaritë komunale. Për një proces buxhetor më transparent, jep keshilla për KPF mbi buxhetin komunal, menaxhon llogaritë komunale dhe raportet vjetore financiare I raporton në Kuvend, menaxhon thesarin, fondet komunale, mbikqyrë dhe monitoron sistemet dhe procedurat për implementimin e buxhetit etj.

2. Sektori i Tatimit në Pronë

Deklarata e misionit: Menaxhon ekskluzivisht vetëm tatimin në prone, përgatitjen e faturave, distribuimin e faturave tatimore, inkasimin e tatimit në prone dhe raportimin e rregullt pranë MF.

3. Sektori I Financave

Deklarata e misionit: Menaxhon Inkasimet e llogarive të arkëtueshme të taksave për ushtrim të veprimtarisë për biznese si dhe menaxhimin qirave të pronave komunale të dhëna me qira.

4. Zyra e Thesarit

Deklarata e misionit: Menaxhon të gjitha shpenzimet e komunës sipas udhëzimeve të dala nga MF ,për secilin department.

2. SITUATA AKTUALE

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për vitin 2024 ka realizuar objektivat e planifikuara – **Inkasimet e llogarive të arkëtueshme**, tatimit në pronë, taksave për ushtrim të veprimtarisë për biznese, dhe për qira.

Per vitin 2024 kemi arritur inkasojme nga planifikimi i të hyrave tatimore dhe jo tatimore me aktiveitetet e ndermarrja si ne Sektorin e Tatimit ne Prone po ashtu edhe në Sektorin Taksave Komunale .Kete e kemi realizuar duke përdorur metoda të ndryshme si me shperndarjen e leterkujtesave ,njoftimeve perfundimtare si dhe njoftimieve per pezullim per sherbime komunale.Gjithashtu çdo tatimpagues I cili ka vizituar sektorin e tatimit në prone dhe ka pasur obligime ia kemi mundësuar lidhjen e kontrates me mundesi pagese me keste.Gjatë vitit 2024 kemi lidhur 102 kontrata të cilat monitorohen rregullisht nga zyrtarët e sektorit dhe telefonohen në rast të vonesave.Vlen të theksohet se gjatë vitit 2024 kemi realizuar 300,135.89 euro,ndërsa planifikimi ishte 593,895.00 euro,dmth se kemi te realizuar shprehur ne % **50.54 %**. Borxhi I përgjithshëm deri me datën 31.12.2024 është 1,539,234.56 euro, Gjithashtu si objective ka qenë edhe realizimi I rianketimeve të objekteve ekzistuese për 20 %,mirëpo gjatë 2024 kemi realizuar 2970 nga 13,855 rianketime dmth kemi arritur të realizojmë 21.43% të rianketimeve. Objektivë tjetër ka qenë regjistrimi I objekteve të reja,ku gjatë vitit 2024 kemi realizuar 1388 regjistrime të reja.

Rezultate kemi pasur edhe në sektorin e taksave komunale ku gjatë vitit 2024.Planifikimi për taksa komunale mbi shoqërit tregtare për vitin 2024 ishte **50,000.00 €**, ndërsa realizimi deri në fund të vitit arritit në **77,472.10 €**, ose shprehur në përqindje **125.32 %**.

Planifikimi për taksa nga qiraja për objektet afariste, banesore dhe tokave bujqësore për vitin 2024 ka qenë **24,000.00 €**, ndërsa realizimi deri në këtë periudhë kohore është **34,247.60 €** ose shprehur në përqindje **142.70 %**.

Duhet të theksojmë që borxhi i përgjithshëm i subjekteve afariste prej viteve paraprake deri më datën 31.12.2024 është **358,112.08 €** dhe nëse e krahasojmë me vitin 2023 ku borxhi i përgjithshëm ishte **371,702.32 €** kemi rënie të borxhit të përgjithshëm prej **13,550.24 €** apo **3.65 %**.

Sa i përket proceseve tjera, mangësi të shumta që kemi gjetur në pasuritë komunale kemi ndërrmar hapa drejt përmisimit sidomos të E-pasuritë-gjendja fizike dhe gjendja në sistem si dhe të pasuritë mbi 1,000.00 euro ku duhet të bëhet identifikimi i pronave komunale.Këto përmisime jemi duke I bërë me ndihmën e komisioneve që kemi formuar për secilin proces.

3.OBJEKTIVAT E DREJTORISË PËR FINANCA DHE BUXHET 2026-2028

- Objektivat

1.Realizimi i planit të inkasimit në Sektorin e Tatimit në Pronë dhe Sektorin e Taksava Komunale

- 2.Regjistrimi i objekteve të reja dhe rianketimi 20% I pronave ekzistuese
- 3.Zvogëlim i borxheve aktuale
- 4.Përfshirje sa më e gjerë e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinnor në institucion dhe analizë gjinnore nëpër gjitha drejtoritë
- 5.Fuqizimi i lidhjes ndërmjet planifikimit dhe buxhetimit
- 6.Hartimi i librit të proceseve për Komunën e Kamenicës
- 7.Përmisimi i menaxhimit të pasurive komunale
8. Fuqizimi i transparencës dhe gjithëpërfshirjes së raportimit dhe shqyrtimit të buxhetit;

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve:

- 1.-Organizimi i fushatave senzibilizuese me qytetar lidhur me obligimet e tyre,njoftimet e tyre me vleren,tatimin mbi tokën,njoftime gjithashtu edhe në faqen e komunës
2. -Mobilizimin e zyrtarëve në teren
 - Vënia në dispozicion të një automjeti për së paku tre ditë në javë gjatë tërë vitit
3. -Shpërndarja e Letërkujtesave për të gjithë obliguesit
 - Shpërndarja e Njoftimeve Përfundimtare për të gjithë tatimpaguesit që nuk i përgjigjen letërkujtesës
 - Hartimi i kontratave për riprogramimin e borxheve për të gjithë tatimpaguesit që kanë borxhe mbi 100 euro dhe kontaktimi i palëve për cdo vonesë në pagesë
 - Shpërndarja e Njoftimeve për pezullimin e shërbimeve komunale për obliguesit që nuk i përgjigjen Njoftimeve Përfundimtare
 - Zhvillimi i kampanjës informuese të tatimpaguesëve për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara përmes përmbaruesit
- 4.- Komuna duhet të caktojë një zyrtar për grumbullimin dhe mbledhjen e të dhënave gjinnore për cdo aktivitet në kuadër të një Drejtorie
 - Fushatë e re për Buxhetim Gjinnor nga praktikat dhe përvojat e fituara nga takimet dhe punëtori
 - Një analizë e buxhetit nga aspekti gjinnor në fushën e investimeve kapitale
 - Një analizë e buxhetit nga aspekti gjinnor në fushën e kategorisë për mallra dhe shërbime
 - Komuna duhet të ketë një rregullore të brendshme komunale për mbledhjen e të dhënave nga aspekti gjinnor
- 5.- Arrihet në kordinim të plotë me drejtoritë komunale
 - Planifikim i mirë i buxhetit para aprovimit në Kuvend
- 6.-Arrihet duke angazhuar një komision përfshire nga një përfaqësues nga të gjitha drejtoritë
- 7.-Me komisionin për vlerësimin e pasurive jofinanciare nën 1,000.00 euro duke paraqitur në mënyrë të detajuar për secilën pasuri edhe vlerësimin dhe pastaj modifikimi në E-pasuri.
 - Me komisionin për identifikimin e pronave komunale në SIMFK

TRENDET E FINANCIMIT 2026 DHE VLERËSIMET 2027-2028

Buxheti	2024 Shpenzuar	2025 Buxheti	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar
Stafi	25	25	25	25	25
Paga dhe Meditja	172,448.52	184,137.66	220,000.00	220,000.00	220,000.00
Mallra dhe sherbime	21,051.00	25,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale					
TOTALI	193,499.52	209,137.66	240,000.00	240,000.00	240,000.00
Burimet e Financimit				-	-
Grandet Qeveritare	192,991.78	209,137.66			
Te hyrat vetanake	507.74				

1. Misioni:

Misioni i DSHPAIE është ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike duke përfshirë:

- menaxhimin e mbeturinave,
- zgjerimin e rrjetit të mbeturinave duke i përfshi të gjitha lokalitetet e komunës,
- mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale,
- mirëmbajtje e parqeve shesheve e hapësirave të gjelbra,
- realizimi i projekteve për pastrimin e ambientit,
- pastrimi i deponive ilegale,
- sinjalizimi vertikal dhe horizontal,
- transporti lokal,
- dhënia e vijave urbane, dhe urbano-periferike,
- mirëmbajtja e ndriçimit publik,
- zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik,
- përcjellja dhe pagesa e shërbimeve komunale ,
- furnizim me ujë,
- kanalizimet dhe drenazhimet,
- trajtimi i ujërave të zeza,
- hartimi i planeve dhe rregulloreve komunale,

2. Situata Aktuale:

Përkushtimi aktual i drejtorisë është ofrimi i shërbimeve kualitative dhe rritja e vetëdijes tek qytetarët, si dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike. Të arriturat kanë qenë në një nivel të mirë duke pasur para sysh buxhetin si dhe numrin e stafit profesional për realizimin e projekteve.

Do të vihen në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe financiare që kjo të arrihet. Përmes këtyre aktiviteteve në të ardhmen do të krijohen kushte të favorshme për rritjen e nivelit të investimeve nga burimet vetanake. Ka pasur disa sfida për shkak të mungesës së buxhetit ku disa projekte nuk kanë mundur të realizohen plotësisht, psh. shtruarja e rrugëve me zhavorr, Sinjalizimi vertikal dhe horizontal, pastaj nuk ka pasur mundësi të intervenohet në disa vende ku është e nevojshme rregullimi i rrjeti të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Përafrimi i përmbushjes së një vizioni të tillë do të krijonte parakushte më të mira për investime edhe nga donatorët.

3. Objektivat dhe Aktivitetet:

Zbatimi me përpikëri i planit të punës së drejtorisë për vitin 2025, ku janë të specifikuar të gjitha objektivat, aktivitetet si dhe bartësit e aktiviteteve duke zbatuar edhe afatet kohore. Qëllimi është synimi afatgjatë i cili mundë të arrihet në një moment përtej planit afatmesëm.

Disa politika kanë një shtrirje shumë të gjatë kohore, dhe kjo duhet të reflektohet në periudha të më vonshme.

	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
DSHPAIE	Vlerësuar	Vlerësuar	Vlerësuar
Paga dhe Mëditje	440,434.00	494,615.00	544,075.00
Mallra dhe shërbime	420,650.00	367,660.00	369,750.00
Shpenzime komunale	165,000.00	168,500.00	172,650.00
Investime kapitale	293,000.00	390,865.00	580,800.00
Rezerva			
TOTALI	1,319,084.00 €	1,421,640.00 €	1,330,861.00 €
<i>Burimet e Financimit</i>			
Grandet Qeveritare	1,064,084.00	1,241,640.00	1,120,861.00
Te hyrat vetanake	255,000.00	180,000.00	210,000.00
Grantet dhe Donatoret			

Mallra dhe Shërbime:

Nr	Bloku kodues	Kategoria	Vlera në €
1	14060	Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra	80,565.00
2	14030	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve Lokale	250,000.00
3		Mirëmbajtja e ndriçimit Publik	35,000.00
4	14030	Sinjalizimi vertikal dhe Horizontal	45,000.00
5	13141	Mëditjet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	500.00
6	13470	Pajisje dhe mjete punuese për mirëmbajtjen e ambientit	1,100.00
7	13610	Furnizimi për zyre	1,000.00
8	13640	Furnizime për aksione të pastrimit	1,000.00
9	13650	Furnizimi me veshmbathje	1,500.00
10	13950	Regjistrimi i automjeteve	500.00
11	13951	Sigurimi i automjeteve	1,100.00
12	14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	2,500.00
13		Mjete të pa parashikuara (ujësjellësi , kanalizimi dhe të tjera)	500.00
14	13810	Avans për para të imëta (p. Cash)	385.00
TOTALI			420,650.00

Shërbimet Komunale

Nr	Bloku kodues	Emërtimi	Shuma në €
1	13210	Shpenzimet e rrymës për Administratën Komunale	36,000.00 €
2	13210	Ndriçimi Publik	120,800.00 €
3	13220	Uji	3,200.00 €
4	13230	Mbeturinat	3,500.00 €
5	13250	Telefonia Fikse	1,500.00 €
TOTALI			165,000.00 €

Investimet Kapitale

Nr.	Projektet	2025	2026	2027
1	Ndërtimi i pritoreve të autobusëve në Kamenicë	70,000.00	50,000.00	40,000.00
2	Blerja e pajisjeve për prodhimin e biomasës dhe mirëmbajtjes së hapsirave publike në Kamenicë	/	70,000.00	120,000.00
3	Ndërtimi i kanaleve të ujërave atmosferike në Koretin, Rogaqicë, L. Çamëria, Hodonoc, Muqiverc	60,000.00	30,000.00	/
4	Ndërtimi i pritoreve të autobusëve në Hogosht, Shipashnicë e poshtme, Hodonoc, Koretin.	5,000.00	/	/
5	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra, Karaqevë, Rogaqicë, Kopernicë, Koretin, Hogosht, Hodonoc, Strezoc., Krilevë, Hajnoc, Berivojcë, Topanicë, Novosellë.	20,000.00	80,000.00	/
6	Ndërtimi i kanaleve të ujërave atmosferike (Hodonoc, Koretin, Berivojcë, Muqiverc, Kamenicë	50,000.00	30,000.00	/
7	Ndërtimi i rajoneve të sentimentimit për trajtimin e ujërave të zeza në Hogosht, Busavatë dhe Kopernicë	40,000.00	50,000.00	/
8	Ndërtimi i ashensorëve në ndërtesa publike në Kamenicë	28,000.00	20,000.00	/
9	Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatra, (Shipashnicë, Karaqevë, Berivojcë, Busavatë, Hodonoc, Koretin, Topanicë, faza 2.	20,000.00	30,000.00	70,000.00
	T O T A L I	293,000.00		
Burimet e Financimit				
	Grandet Qeveritare	138,000.00		
	Te hyrat vetanake	155,000.00		

Objektivat Kryesore :

1. Rritja e hapësirave gjelbëruese në komunën e Kamenicës,
2. Mirëmbajtja e Hapësirave të hapura publike në baze të planit për mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike;
3. Mirëmbajtja e rrugëve lokale në komunën e Kamenicës, (rritja e buxhetit);
4. Zgjerimi i rrjetit 100% në fushën e mbeturinave;
5. Rritja e inkasimit, dhe inkasimi i borxheve nga shfrytëzuesit e HP (kioskat dhe garazhet);
6. Mirëmbajtja e infrastrukturës;
7. Vendosja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal, (rritja e buxhetit për sinjalizim);
8. Përmirësimi në furnizimin me ujë;
9. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësve në lokalitete të ndryshme;
10. Arritja e marrëveshjes me kompanin “Hidromorava për menaxhimin e rrjetit të kanalizimit në lokalitetet ku nuk menagjohet nga ata;
11. Përfundimi dhe funksionalizimi i projektit të ujësjellësit në Roganë, Muqiverc, Dajkoc, Shipashnicë e Poshtme, Novosellë dhe Hodonoc;
12. Ndërrimi i gypave të ujësjellësit në lagjen Iliria, dhe Berivojcë;

13. Përfundimi i punimeve të bulevardit në qendër, me gjithë infrastrukturën përcjellëse;
14. Rregullimi dhe sinjalizimi i parkingjeve në qytet;
15. Furnizimi dhe vendosja e numrave në objekte sipas sistemit të adresave;
16. Funksionalizimi i NPL “DARDANA” , e cila do të merret me disa fushëveprimtari të ndryshme si:
17. Mirëmbajtjen dhe menaxhimin e hapësirave të gjelbra komunale në qytet,
18. Menaxhimin e lokacioneve për deponimin e materialeve të ngurta,
19. Sinjalizimi vertikal dhe horizontal,
20. Mirëmbajtja dhe menaxhimi i parkingjeve publike në qytet,
 - Menaxhimi i mbeturinave të ngurta dhe familjare,
 - Sinjalizimi vertikal dhe Horizontal,
- Rritja e numrit të stafit profesional;
- Caktimi i një lokacioni për stacionin e autobusëve;
- Caktimi lokacioneve për deponimin e materialeve të ngurta!

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :

1. Rritja e hapësirave të gjelbra do të bëhet duke hartuar projekte në fushën e ambientit dhe do të kërkohen donator, në bashkë investim me Komunën;
2. Mirëmbajtja e HHP do të bëhet në harmoni të plotë me planin e hartuar nga DEMOS dhe Komuna, për Mirëmbajtjen e HHP dhe Planin Investiv;
3. Zgjerimi i rrjetit në fushën e mbeturinave do të bëhet konform planit për Menaxhimin e Mbeturinave, në bashkëpunim me kompaninë Ecohigjiena;
4. Rritja e inkasimit do të bëhet duke filluar ngarkesën me taksë për të gjitha kioskat dhe garazhet dhe duke i njoftuar pronarët faktik me masat që do të merren për mos kryerje të obligimeve;
5. Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore do të bëhet duke rritur shumën e mjeteve financiare për projektin e mirëmbajtjes së rrugëve lokale, në harmoni me kërkesat e qytetarëve;
6. Vendosja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal do të bëhet duke rritur vlerën e projektit, dhe duke ju përshtatur nevojave të sinjalizimit në terren;
7. Përmirësimi i furnizimit me ujë do të bëhet duke e ndaluar formën e ujitjes, ujitjen e kopshteve, te autolarjet, si dhe duke kërkuar burime të reja të ujit;
8. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit do të bëhet në koordinim me KL, duke marrë pjesë në participim, dhe duke kërkuar donator nga jashtë;
9. Nënshkrimi i marrëveshjes me KRU “Hidromorava” për marrjen në menaxhim të ujrave të zeza;
10. Pasi jemi në fazën e fundit të zhvillimit të punëve, presim që të përfundoj projekti në tërësi dhe të fillojmë me kyçjet individuale të qytetarëve të fshatrave Muqiverc, Dajkoc, Shipashnicë e Poshtme, Rogaqicë, Novosellë dhe Hodonoc.
11. Përfundimi i punëve të bulevardit në qendër, me gjithë infrastrukturën përcjellëse do të bëhet në zbatim të plotë të planit dinamik, dhe shfrytëzimi i HP në këtë pjesë;
12. Rritja e numrit të stafit profesional do të bëhet sipas organogramit të drejtorisë.

TRENDET E FINANCIMIT 2026 DHE VLERËSIMET 2027-2028

Infrastruktura Publike	2024 Shpenzuar	2025 Buxheti	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar
Stafi	17	20	20	20	20
Paga dhe Meditja	170,505.77	164,026.30	210,000.00	210,000.00	210,000.00
Mallra dhe sherbime	269,719.20	365,650.00	400,000.00	400,000.00	400,000.00
Shpenzime komunale	154,970.33	165,000.00	165,000.00	168,500.00	172,650.00
Subvencione dhe transfere	471,549.11				
Shpenzime kapitale		293,000.00			
TOTALI	1,066,744.41	987,676.30	775,000.00	778.500.00	782,650.00
Burimet e Financimit			-	-	-
Grandet Qeveritare	735,133.74	732,676.30			
Te hyrat vetanake	331,610.67	255,000.00			

NJËSIA PROFESIONALE E ZJARRËFIKJES DHE SHPËTIMIT

1.MISIONI

Si reaguesit e parë ndaj zjarrit, sigurisë publike dhe emergjencave mjekësore, fatkeqsive dhe akteve terroriste, Njësia Profesionale e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit në Komunën e Kamenicës me nënstacionin në fshatin Muçivërc mbron jetrat dhe pronat e pasuritë e banorëve dhe vizitorëve në territorin e Komunës së Kamenicës. Njësia Profesionale e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit e avanson sigurinë publike përmes programeve për parandalimin e zjarrit, hetimeve dhe programeve edukative. Ofrimi me kohë i këtyre shërbimeve e mundëson që Njësia Profesionale e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit në Kamenicë me nënstacionin në fshatin Muçivërc të japë një kontribut të rëndësishëm për sigurinë e qytetit, të zonës së përgjegjësisë dhe përpjekjeve të sigurisë kombëtare.

2.SITUATA AKTUALE

Njësia Profesionale e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit mbulon territorin e Komunës së Kamenicës dhe Ranillugit e cila shtrihet në pjesën lindore të Kosovës, e cila kufizohet me Komunën e Gjilanit, Artanës (Novobërdës), Prishtinës dhe me territorin e Serbisë me Komunën e Medvegjës, Vranjës dhe Bujanovcit. Zona e përgjegjësisë ka objekte me rëndësi administrative, industriale, kulturore, religjioze etj, në të cilën 35 vendbanime janë të banuar vetëm me shqiptar, 27 vetëm me serbë dhe 14 të përziera.

Njësitë Profesionale të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit – janë njësi profesionale operative që marrin pjesë në intervenimet për zjarrfikje dhe shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë në situata emergjente, si dhe zbatimin e masave parandaluese të mbrojtjes nga zjarri dhe kryerjen e veprimtarive tjera të përcaktuara me ligj.

Natyra e punës të Njësia Profesionale e zjarrfikëse dhe shpëtimit në përgjithësi ka specifika të veçanta që dallojnë shumë nga puna e shërbimeve, institucioneve, agjencive dhe organizatave të tjera.

Puna e zjarrfikësve bazohet në: Profesionalizëm, Përgjegjësi të përhershme, Gatishmëri konstante, Siguri, Humanizëm, Shpejtësi, Kreativitet, Objektivitet dhe Diciplinë vullnetare etj.

Punën e përditëshme të zjarrfikësit e karakterizon: Veprimi nën ndikim të rrezikut permanent për jetë, gjatë aksioneve të fikjes së zjarrit dhe shpëtimit të njerëzve e të pronës si: puna në lartësi, podrumet e thellësi nëntokësore, në ujë gjatë vërshimeve të mëdha, kërkim-shpëtimin e personave të rrezikuar në/nën ujë, në ndikimin e temperaturave të larta, temperaturave shumë të ulëta, puna në zona me rrezik nga rrënimet strukturale, në zona të kontaminuara me materie të rrezikshme helmuese, korrozive, biologjike dhe radioaktive.

Zjarrfikësi kujdestaron pandërprerë me nivel të lartë gatishmërie me punë në ndërrime, gjatë festave kombëtare e shtetërore, madje edhe në pushimet dimërore dhe verore.

3.OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

1.MPB/AME në bashkëpunim me Komunën duhet të ndërtojë Stacion të ri me 6 garazha me infrastrukturë moderne për t'i zhvilluar aktivitetet profesionale dhe rritjen e gatishmërisë.

2.Të rritet numri i zjarrëfikësve për 8 zjarrfikës, ku 4 zjarrfikës do të punësohen në Stacionin Qendra në Kamenicë dhe 4 zjarrëfikës në nënstacionin në Muçivërc.

3.Të bëhet furnizimi me një kamion cistern (tanker) me kapacitet 10,000 deri 12,000 litra ujë si **dhe dy automjete komandues e modelit xhip me drita rotacioni dhe alarm.**

4.Trajnimi i përditshëm i zjarrëfikësve në Stacion sipas planit javor/vjetor

5.Ushtrimet psiko-fizike

6. Analiza e Intervenimeve - zjarreve dhe Debriefingu

Objektivat e mësipërme të NJPZSH do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :

- Motivi për punë
- Stafi mirë i trajnuar
- Gatishmëria për tu përgjigjur për mobilizim dhe pranuar punë shtesë
- Puna grupore dhe rutina në punë
- Mirmbajtja e stacionit dhe riparimi i automjeteve

TRENDET E FINANCIMIT 2026 DHE VLERËSIMET 2027-2028

ZJARREFIKSET	2024 Shpenzuar	2025 Buxheti	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar
Stafi	33	33	33	33	33
Paga dhe Meditje	268,008.49	164,026.30	325,000.00	325,000.00	325,000.00
Mallra dhe shërbime	43,630.30	55,000.00	45,000.00	45,000.00	45,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale					
TOTALI	311,638.79	219,026.30	370,000.00	370,000.00	370,000.00
Burimet e Financimit			-	-	-
Grandet Qeveritare	311,638.79	219,026.30			
Te hyrat vetanake	-				

ZYRA LOKALE PER KOMUNITETE

Zyra komunale për komunitete dhe kthim promovon, konfirmon, përkrah, implementon dhe mbikëqyrë aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me promovimin e të drejtave të komuniteteve, qasje të barabartë e të gjitha komuniteteve, shërbimeve publike si dhe krijimii i kushteve për kthim të qëndrueshëm dhe integrim të refugjatëve, të personave të zhvendosur dhe personave të kthyer në procesin e riatdhesimit.

Zyra vepron në harmoni me Kushtetuten, ligjet dhe me politikat e promovimit të drejtave të mbrojtjes të komuniteteve dhe pjesëtarëve të saj, qasje e barabartë e komuniteteve në shërbimet publike, si dhe krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm dhe reintegrim, duke përfshirë dokumentet strategjike dhe planet e veprimit të Qeverisë të cilët kanë të bëjnë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe në kthim si dhe reintegrim.

Sipas ligjit dhe kompleksitetit të problemeve, të cilat i ka Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në kuadër të aktiviteteve të saj, është ndier nevoja për të hartuar planin vjetor të punës.

Plani i Punës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe kthim bazohet në Rregulloren për Zyret Komunale për Komunitete dhe Kthim, Rregulloren 10/2012 për menaxhimin e programit, organet kompetente, veprimet dhe kriteret e përfitimeve për personat për integrim dhe riatdhesim si dhe në Strategjinë Kombëtare për Komunitete dhe Kthim 2014-2018, Planin e Veprimit për Kthim dhe Rregullores 01/2018. Për Kthim dhe integrim të personave të zhvendosur.

Kapacitetet e Zyres Komunale për Komunitete dhe Kthim

Përparsitë:

- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ka prioritetet dhe objektivat e saj
- Mundësia e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe Ministrinë relevante e cila merr pjesë në procesin e kthimit dhe riatdhesimit
- Përvoja e stafit të zyrës për çështjet e kthimit, komuniteteve dhe personave të riatdhesuar
- Krijimi i Strategjisë për Kthim dhe Komunitete dhe Plani Akcinonal Lokal për kthim
- Formimi i “OKR-së”
- Plani i veprimit
- Ekzistimi i buxhetit për ZKKK-në
- Databaza për kthim dhe komunitete dhe personat e riatdhesuar
- Projekti aktual i kthimit EURRK V

Mundësitë:

- Trajnimi për stafin e ZKKK-së nga lëmi Exsel për përpunimin e shënimeve
- Trajnimi për stafin e ZKKK-së në gjuhen

Dobësitë:

- Pajisje e pamjaftueshme teknike e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Përgatitja e pamjaftueshme e stafit për punë të IT-së
- Njohuritë elementare të gjuhës Shqipe dhe Angleze
- Mosekzistimi i databazës së përbashkët për kthim
- Pamjaftueshmeri e stafit komunal për punë në projektet zhvillimore për komunitetin
- Pamjaftueshmëria e aktiviteteve në informimin e personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar për të drejtat e tyre
- Nivel i ulët e komunikimit ndëretnik në fshatra të një komuniteti
- Problem i pazgjidhur për pronën për të kthyerit

Kërcënimet:

- Të mundëshme rrethana të paparashikuara (incidente)

- Shqipe dhe Angleze
- Furnizimi me pajisje adekuate
- Organizimi i vizitave Shkolla dhe Shif me qëllim të informimit të zhvendosurve, të anëtarëve të komunitetit për projektet aktuale
- Organizimi i punëtorive, tryezave për komunitete
- Dërgesa të kërkesave për ndihmë për të kthyerit, Ministrisë për Khim dhe Komunitete si dhe projekte te OJQ-të ndërkombëtare
- Bashkëpunim i mirëfillt me MPB-në për zyre për personat e riatdhesuar
- Dërgesa të kërkesave KK-së me qëllim të ndarjes së tokës për akomodim të përkohshëm
- Trendi i reduktuar i kthimit në periudhën dimërore
- Mungesa e akomodimit të përkohshëm për të kthyerit
- Ndryshimi i ligjit apo rregulloreve për personat e riatdhesuar

Plani vjetor i ZKKK-së

Plani vjetor i punës për vitin 2026 ka tendencën e kryerjes së aktiviteteve pa pengesë lidhur me sfidat të cilat i ka dhe me të cilat i ushtron Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim e cila është e përkushtuar në përkujdesjen e pakufi të personave të zhvendosur, të kthyerëve, anëtarëve të komuniteteve joshumicë dhe integrimin e të riatdhesuarëve. Me këtë plan vjetor janë përfshirë objektivat në harmoni me angazhimin e rregullt të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për të cilën është i nevojshëm buxheti.

Qëllimet e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për vitin 2026-2028 janë:

1. Të shtohet informimi i personave të zhvendosur, të kthyerëve dhe të riatdhesuarëve për të drejtat e tyre dhe rritja e kapaciteteve të tyre si dhe arsimimi joformal në harmoni me ligjin mbi barazinë gjinore.
2. Promovimi i dialogut ndëretnik përmes kulturës, dhe sportit si dhe inicimi i bashkëpunimit ndëretnik në mesin e të rinjëve dhe grave si dhe ofrimi i përkrahjes për takime të tilla.
3. Rritja e përfshirjes sociale për të kthyerit dhe personat e atdhesuar përmes bashkëpunimit me Qendrën për punë sociale dhe me OJQ-të.
4. Promovimi i potencialit ekonomik të Kamenicës te komunitetet dhe donatorët.

Qëllimi 1. *Të shtohet informimi te personat e zhvendosur, të të kthyerit dhe personat e riatdhesuar për të drejtat e tyre, shtimi i kapaciteteve të tyre në arsimimin joformal në harmoni me ligjin mbi barazinë gjinore*

SWOT Analiza

Prirotetet: - Zyra Komunale e Krijuar për Komunitete dhe Kthim - Mundësia e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe Ministrinë relevante e cila merr pjesë në procesin e kthimit - Formimi i “OKR-së” - Përvoja e stafit të zyrës është në ngritje e sipër - Krijimi i Strategjisë për Kthim dhe Komunitete dhe Plani i Veprimit për Kthimin - Ekzistimi i buxhetit për nevoja të zyrës - Ekzistimi i buxhetit për ZKKK-në	Dobësitë: - Pamjaftueshmëria informative për personat e zhvendosur - Buxhet i pamjaftueshëm për aktivitetet e ZKKK-së
Mundësitë: - Organizimi i tryezave dhe punëtorive për të kthyerit - Organizimi i vizitave Shko dhe Shif për të kthyerit - Gjendja e mirë e sigurisë në Komunë - Ekzistimi i fondeve MKK-së për ndihmë për të kthyerit dhe projektit në Komunë - Zhvillimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare	Kërcënimet - Të mundëshme rrethana të paparashikuara (incidente) - Zvogëlimi i trendit për kthim në periudhën dimërore - Mungesa e akomodimit të përkohshëm për të kthyerit - Ndryshimi i ligjit ose rregulloreve për kthim

Qëllimi 2. *Promovimi i dialogut ndëretnik përmes kulturës dhe sportit dhe inicimi i bashkëpunimit ndëretnik në mes të rinjëve dhe grave si dhe ofrimi i përkrahjes tubimeve të tilla.*

SWOT Analiza

Prioritetet: - Zyra Komunale e krijuar për Komunitete dhe Kthim - Mundësia e bashkëpunimit me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim - Krijimi i Strategjisë për Kthim dhe Komunitete dhe Plani Akcional Lokal për pajtim ndëretnik si dhe Plani i Veprimit për mbrojtjen e fëmijëve - Bashkëpunimi i Mirë me drejtorinë komunale - Bashkëpunimi i mirë me Komitetin për komunitete - Databaza me kërkesat e komunitetit	Dobësitë: - Pajisje profesionale e pamjaftueshme për punë për çështje të komuniteteve - Përvojë e pamjateshme e Koordinatorit dhe zyrtarëve për punë në çështjet e komuniteteve - Buxheti i pamjaftueshëm për aktivitete të zyrës
Mundësitë: - Aplikimi për projekte të organizatave ndërkombëtare - Dërgimi i kërkesave për ndihmë Ministrisë për komunitete dhe kthim - Dërgimi i kërkesave Komitetit për	Kërcënimet: - Të mundëshme rrethana të paparashikuara (incidente) - Ndryshimi i ligjit ose rregulloreve

komunitete - Bashkëpunimi i mirë me drejtoritë komunale	
--	--

Qëllimi 3. Rritja e përfshirjes sociale të të kthyerve dhe personave të riatdhesuar përmes bashkëpunimit me Qendrën sociale për punë dhe OJQ-ët lokale

SWOT Analiza

Prioritetet: - Formimi i ZKKK-së - Mundësia e funksionimit dhe bashkëpunimit të MKK-së, MPB-së - Bashkëpunim i mirë me OJQ-të e të Rinjëve dhe OJQ-të e Grave - Automjeti - Databaza e të kthyerve dhe personave të riatdhesuar - Bashkëpunimi i mirë me OJQ-të ndërkombëtare (UNHCR, KAAD, ECOMY, IOM, UNDP, OSCE) - Bashkëpunimi i mirë me Grupin Joformal të Grave - Bashkëpunimi i mirë me Zyrën për të drejtat e Njeriut	Dobësitë: - Përvojë e pamjateshme e Koordinatorit dhe zyrëtarëve për punë në çështjet e komuniteteve - Buxheti i pamjateshëm për aktivitete të zyrës
Mundësitë: - Aplikim për projekte te organizatat ndërkombëtare - Dërgimi i kërkesave për ndihmë komunitetit, Ministrisë për komunitete dhe kthim - Dërgimi i kërkesave Komitetit për Komunitete - Bashkëpunimi i mirë me Drejtoritë komunale	Kërcënimet: - Ndryshimi i ligjit ose rregulloreve

Qëllimi 4. Promovimi i potencialit ekonomik Kamenicë te komunitetet dhe donatorët

SWOT Analiza

Prioritetet: - Formimi i ZKKK-së - Mundësia e funksionimit dhe bashkëpunimit	Dobësitë: - Përvojë e pamjateshme e Koordinatorit
--	---

të MKK-së, MPB-së - Automjeti - Databaza e të kthyerve dhe personave të riatdhesuar - Bashkëpunimi i mirë me OJQ-të ndërkombëtare (UNHCR,KAAD,ECMY,IOM,UNDP,OSCE) - Bashkëpunimi i mirë me komitetin për komunitete - Ekzistimi i rrjetit të Komiteteve për komunitete - Bashkëpunimi i mirë me ZKKK-et në Rajon	dhe zyrtarëve për punë në çështjet e komuniteteve - Buxheti i pamjaftueshëm për aktivitete të zyrës
Mundësitë: - Aplikimi për projekte te organizatat ndërkombëtare - Dërgimi i kërkesave për ndihmë komunitetit Ministrisë për komunitete dhe kthim - Dërgimi i kërkesave Komitetit për Komunitete - Bashkëpunimi i mirë me Drejtoritë komunale	Kërcënimet: - Ndryshimi i ligjit ose rregulloreve

Aktivitetet

Aktivitetet për qëllimin 1.	Periudha	Përgjegjësia	Resurset/Buxheti euro
1. Përgatitja, shtypja dhe distribuimi i „flajerve“informativ me shënimet për të drejtat në kthim, riatdhesim dhe ligjin mbi barazinë gjinore në masë prej mbi 200 copë/njësi.	01 Mars -01 Prill	-Zyrtari për informim - Udhëheqësi i ZKKK-së -Koordinatori për kthim -Zyrtari për kthim	800
2. Organizimi i vizitës Shko dhe Shif për personat e zhvendosur në vendet e zhvendosura në Serbi në lokalitetet Nish, Jagodinë dhe Beograd	01 mars -01 prill	- Udhëheqësi i ZKKK-së -- Koordinatori për kthim Zyrtari për kthim -Zëvendësi i Kryetarit për	1200

		komunitete	
3. Organizimi i tryesës për anëtarët relevant të „OKR-së“ me temën forcimi i kapaciteteve të arsimimit joformal të kthyerëve, të riatdhesuarëve në harmoni me ligjin mbi barazinë gjinore	01-15 maj	- Anëtarët e grupit punues komunal - MPB-a - Donatorë potencial	500
4. Organizimi i tryezës me temën „Kthim në Kamenicë prej OJQ-së lokale 2 prej komunitetit serb dhe me përfaqësues të 10 fshatrave në Komunën e Kamenicës me banorë serb me temën „Integrimi i kthimit“	01 qershor-01 korrik	-ZKKK-a --Zëvendësi i Kryetarit për komunitete - Zytari për informim -Kryesuesi i Komitetit për Komunitete - Zytari për të Drejtat e Njeriut -Shefi i Kadastrit -Shefi i Zyrës Civile -UNHCR -MKK-a -SHPK-a	500
5. Inicicimi dhe promovimi i vlevshmërisë të konferencës së donatorëve me temën “Më shumë punësim për kthim të sigurt” për Rajonin e Anamoravës	01 gusht – 01 shtator	- ZKKK-a - Kryetari - Zëvendësi i Kryetarit për komunitete - Zëvendësi i Kryetarit - Zytari për informim - Zyra për Integritet Evropiane	200
Nëntotali për qëllimin 1.			3,200.00
Aktivitetet për qëllimin 2	Periudha	Përgjegjësia	Resurset/Buxheti euro
1. Organizimi i tryezës me temën “Dialogu ndëretnik-Interkulturalizmi” me 40 të rinj të komuniteteve, shqipëtare, serbe dhe rome nga Komuna e Kamenicë, Ranillugut, Novobrdës dhe Gjilanit	07-14 shkurt	-Anëtarët e ekipit për dialog ndëretnik në Kamenicë, Novobërd, Ranillug dhe Gjilan	300

2. Organizimi i aktiviteteve ndëretnike sportive me 50 të rinj nga shkollat fillore dhe të mesme të Novobërdos, Parteshit, Ranillugut dhe Gjilanit	10 qershor - 20 korrik	-Koordinatori për komunitete -Zyrtari për komunitete -Zyrtari për Informim	360
3. Organizimi i pjesëmarrjes të komunitetit Rom nga Berivojci për Ditën e Romëve.	01-07 maj	-Koordinatori dhe zyrtari për komunitete -Përfaqësuesi i komunitetit Rom në fshatin Bberivojcë	300
4. Organizimi i aktiviteteve për nderë të shënimit të “Ditës të Refugjatëve” me nga 20 të rinj të komunitetit shqiptar dhe serb	01 qershor – 30 qershor	-Udhëheqësi i ZKKK-së -Koordinatori për komunitete -Zyrtari për komunitete -Anëtarët e Ekipit për Dialog	300
Nëntotali për qëllimin 2			1260
Aktivitetet për qëllimin 3	Periudha	Përgjegjësia	Resurset/Buxheti euro
1. Organizimi i takimeve të 10 të kthyerëve dhe 10 të riatdhesuarëve me Komitetin për Komunitete në Komunën e Kamenicës, me Drejtorinë për Punë Sociale dhe me OJQ-të lokale.	01 shtator – 20 shtator	- Udhëheqësi i ZKKK-së - Zëvendësi i Kryetarit për komunitete Anëtarët e Komitetit për komunitete Drejtoria për Punë Sociale Përfaqësuesit e OJQ-ve lokale	350
02 Organizimi i sesioneve me personat e riatdhesuar dhe të kthyerit me temën: “Idetë tona për projekte”. Përmes aftësimit për referimin e iniciativave qytetare dhe pjesëmarrja në debatet publike për buxhetin	01 prill-30 prill	Udhëheqësi i ZKKK-së Zëvendësi i Kryetarit për komunitete Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim ekonomik LAG OJQ-të	350
Nëntotali për qëllimin 3			700

Aktivitetet për qëllimin 4	Periudha	Përgjegjësia	Resurset/Buxheti euro
1. Përkrahje mbajtjes “Java e aktivitetit të grave” në Kamenicë përmes prezantimit të trashëgimisë historike dhe kulturore në Kamenicë	01.tetor – 30. tetor	-Stafi i ZKKK-së -OJQ-të -Qendra për turizëm -Kryetari	400
2 .Shënimi ditës për Zbutjen e varfërisë përmes prezentimit të kuzhinës shtëpiake në Kamenicë	20.tetor – 20 tetor	-Udhëheqësi i ZKKK-së -OJQ-të -Qendra për turizëm -Zyrtari për informim -Kryetari	500
3. Inicimi dhe promovimi i rëndësisë të konferencës së donatorëve me temën “Potencial Kamenica”	01. gusht– 01. shtator	- ZKKK-ja - Kryetari - Zëvendësi i Kryetarit për Komunitete - Zëvendësi i Kryetarita - Zyrtari për Informim - Zyra për Integritet Evropean - Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	200
Nëntotali për qëllimin 4			1100
Totali			

BUXHETI

Nëntotali për qëllimin 1	3200
Nëntotali për qëllimin 2	1260
Nëntotali për qëllimin 3	700
Nëntotali për qëllimin 4	1100
Totali	6,260.00

TRENDET E FINANCIMIT 2026 DHE VLERËSIMET 2027-2028

ZLK	2024 Shpenzuar	2025 Buxheti	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar
Stafi	8	7	7	7	7
Paga dhe Meditje	50,005.92	50,005.87	65,000.00	65,000.00	60,000.00
Mallra dhe sherbime	3,871.86	5,000.00	5,000.00	5,000.00	15,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere	4,705.34	5,000.00	10,000.00	10,000.00	20,000.00
Shpenzime kapitale					
TOTALI	58,583.12	60,005.87	80,000.00	80,000.00	145,000.00
Burimet e Financimit			-	-	-
Grandet Qeveritare	58,583.12	60,005.87			
Te hyrat vetanake					

Informatë rreth kultivimit të kulturave bujqësore dhe prioritetet e tyre

Misioni:

Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka për mision zhvillimin e Bujqësisë me sektorët e sajë si : sektori i Blegtorisë, Pemëtarisë, Lavërtarisë, Perimëtarisë, dhe përpunimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura, ruajtjen dhe përpunimin e lëndës drusore, vjeljen ,ruajtjen dhe përpunimin e frutave malore, bimëve mjekuese etj. Ka për mision zhvillimin e turizmit rural, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së ushqimit me standardet e BE (ISO dhe HASAP) , rajonizimin e kulturave bujqësore, ruajtjen dhe rregullimin e tokave bujqësore dhe pyjore.

Gjendja aktuale:

Sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Kamenicës është 417 km² prej tyre 58 % janë tokë bujqësore, kurse 42 % janë tokë pyjore. Bujqësia në komunën tonë është sektori më i rëndësishëm pasi që pjesa më e madhe e popullatës së komunës sonë është e angazhuar në këtë sektorë. Gjendja e bujqësisë në komunën tonë karakterizohet me ferma të vogla dhe mesatare 2.2 - 2.4 ha., të shpërndarë në 7 - 8 ngastra për fermë. Me prodhimtari nën mesatare të rajonit, pa mbështetje profesionale. Mbi 70 % e popullatës jeton në zonat rurale,dhe ekskluzivisht merren me bujqësi dhe pylltari.

Drejtorja e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural është e fokusuar në mbajtjen e shënimeve, statistikave të veprimtarive si në punimin e tokave bujqësore ku deri me tash në bazë të statistikave rreth 4000 hektarë janë tokë e punueshme me drithëra grurë dhe misër, ku planifikohet që të rritet sipërfaqja me ujë. Ujitja sistem i lirë do të ndikoj në diversifikimin e kulturave bujqësore, ku në një pjesë të këtyre tokave mund të kultivohen dy prodhime bujqësore brenda një viti kalendarik. Po ashtu objektiv tjetër në këto vite 2025-2028 planifikohet subvencionimi i fermerëve prodhues të qumështit për litër me mundësi rritje për sasi. Objektiv tjetër i DBPZHR do të jetë edhe ruajtja e shëndetit publik përmes projektit me kontrat kornizë për trajtimin e qenëve endacak. Po ashtu objektiv i DBPZHR prapë do të jete sipërfaqja me mbjellje pranverore dhe vjeshtore në subvencionimin e fermerëve me furë të grurit dhe misrit si dhe plehrave minerale.DBPZHR në fokusin e vet ka edhe subvencionimin e fermerëve mbarështrues të kafëshve të imta si dhe fermerët që merren me hortikultur dhe bletari.

Detyrat e Drejtorisë :

DBPZHR, në bashkëpunim me MBPZHR dhe shoqatave të huaja, i ndihmohet fermerëve në mbështetje materiale dhe profesional.

